

RAPORT ANALITIK

AGJENDA E GJELBËR NË SHQIPËRI NGA OBJEKTIVAT *TE BUXHETIMI.*



Funded by
the European Union



Budget
Accountability
and Transparency

Autori: Prof. As. Klodian Muço

2025

Botues: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Rr. Shenasi Dishnica,
Nd. 35, H. 1, 1017, Tirana, Albania P.O.Box 8177. Email: info@idmalbania.org
| Website: idmalbania.org

Riprodhimi i pjesëve të këtij botimi lejohet vetëm duke cituar burimin original.

Ky dokument është prodhuar në kuadër të nismës “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në të i përka-
sin vetëm autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Institute
for Democracy
and Mediation



Fakt@je.al

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtimeve	04
Lista e Tabelave	06
1. Hyrje	07
2. Metodologjia	08
3. Korniza Strategjike dhe Ligjore për Axhendën e Gjelbër në Shqipëri	10
3.1 <i>Kuadri strategjikligjor dhe konventat</i>	
3.2 <i>Sfidat Mjedisore dhe Integrimi i Objektivave Klimatike në Procesin Buxhetor</i>	
3.3 <i>Buxhetimi i Ekonomisë së gjelbër në Shqipëri</i>	
3.4 <i>Financimet nga Donatorët dhe Partnerët Ndërkombëtarë</i>	
4. Tranzicioni i Gjelbër në Shqipëri: Politikat për Dekarbonizim, Ekonomi Qarkulluese dhe Mbrojtjen e Mjedisit	34
4.1 <i>Klima dhe Dekarbonizimi</i>	
4.2 <i>Politikat për Klimë dhe Dekarbonizim</i>	
4.3 <i>Ekonomia qarkulluese</i>	
4.4 <i>Ndotja e ajrit ujit dhe tokës</i>	
5. Gjetjet	42
6. Rekomandimet	43

Lista e Shkurtimeve

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
CBD	Konventa për Larminë Biologjike (Convention on Biological Diversity)
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (European Bank for Reconstruction and Development)
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
EU4Green	Program i BE-së për Tranzicionin e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor
GES	Gaze me Efekt Shtëpie (Greenhouse Gases)
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA III	Instrumenti i Para-Aderimit – Faza III
KFW	Banka Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau)
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MRV	Monitorim, Raportim dhe Verifikim (Monitoring, Reporting and Verification)
NDC	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (Nationally Determined Contribution)
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
NECP	Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (National Energy and Climate Plan)
NGO	Organizatë Joqeveritare (Non-Governmental Organization)

OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
PM _{2.5} / PM ₁₀	Grimca të imta të ndotjes së ajrit me diametër ≤ 2.5 / ≤ 10 mikronë
REACH/CLP	Rregulloret e BE-së për kimikatet
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals)
SIDA	Swedish International Development Cooperation Agency
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPA	Zona të Mbrojtura të Posaçme (Special Protection Areas)
TMD	Teknikat më të Mira të Disponueshme (Best Available Techniques)
UNCCD	Konventa e OKB për Luftën kundër Shkretëtirëzimit (United Nations Convention to Combat Desertification)
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (United Nations Development Programme)
WFD	Westminster Foundation for Democracy
WWTP	Impiant për Trajtimin e Ujërave të Zeza (Wastewater Treatment Plant)

Lista e Tabelave

[Tabela 1. Legjislacionit mbi qëndrueshmërinë, energjinë dhe mjedisin në Shqipëri](#)

[Tabela 2. Konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare në fushën e mjedisit](#)

[Tabela 3. Financimi i pritshëm \(në euro\) nga agenda e reformave 2024-2027](#)

[Tabela 4. Alokimi i fondeve buxhetore për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit sipas PBA](#)

[Tabela 5. Shpenzimet buxhetore faktike për programet e MTM 2022-2024](#)

[Tabela 6. Alokimi i fondeve për MTM sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik](#)

[Tabela 7. Mbrojtja e Mjedisit, shpenzimet faktike 2023-2024 dhe PBA 2025-2027](#)

[Tabela 8. Administrimi i Pyjeve, shpenzimet faktike 2023-2024 dhe PBA 2025-2027](#)

[Tabela 9. Zhvillimi i Turizmit, shpenzimet faktike 2023-2024 dhe sipas PBA 2025-2027](#)

[Tabela 10. Qeverisja vendore për Mbrojtjen e Mjedisit, sipas klasifikimit funksional](#)

[Tabela 11. Shpenzimet për qark për Mbrojtjen e Mjedisit, sipas klasifikimit funksional](#)

[Tabela 12. Mbrojtja e Mjedisit, shpenzimet për rajon sipas klasifikimit funksional](#)

[Tabela 13. Shpenzimet vendore sipas programit dhe numri i bashkive](#)

[Tabela 14. Politikat për klimën dhe dekarbonizimin](#)

[Tabela 15. Prodhimi i qëndrueshëm](#)

[Tabela 16. Ndotja e ajrit dhe menaxhimi i ujit dhe tokës](#)

1. Hyrje

Tranzicioni i gjelbër ka hyrë në një fazë vendimtare për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, e cila ka nënshkruar dhe miratuar një sërë angazhimesh që lidhen me klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky raport analitik synon të shqyrtojë në mënyrë të detajuar përputhshmërinë ndërmjet objektivave politike të vendit në kuadër të Axshendës së Gjelbër dhe strukturës aktuale të ndarjes buxhetore. Në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit, Axshendës 2030 të Kombeve të Bashkuara dhe Axshendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (Sofia 2020), Shqipëria ka ndërmarrë reforma të rëndësishme strategjike për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie me emetime të ulëta karboni. Megjithatë, që këto angazhime të përkthehen në rezultate të prekshme, është thelbësore që ato të mbështeten me burime financiare adeguate, të planifikuara dhe të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme. Në këtë kontekst, ky raport jep një analizë të ekonomike të mënyrës se si Shqipëria ka adresuar përparësitë e saj klimatike dhe mjedisore nëpërmjet planifikimit dhe alokimit buxhetor, si në nivel qendror përmes instrumenteve si Plani Buxhetor Afatmesëm dhe buxheti vjetor i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit po ashtu edhe në nivel lokal. Rezultatet tregojnë se, pavarësisht përpjekjeve pozitive për përafrimin me legjislacionin dhe politikat e BE-së, reflektimi i objektivave të gjelbra në strukturën buxhetore mbetet i kufizuar. Mungesa e një metodologjie të standardizuar për identifikimin dhe etiketimin e shpenzimeve klimatike (green tagging) si dhe fragmentarizimi institucional, përbëjnë sfida reale për zbatimin efektiv dhe koherent të politikave të tranzicionit të gjelbër. Në përgjigje të këtyre sfidave, raporti sugjeron masa konkrete për të rritur koherencën ndërmjet angazhimeve politike dhe instrumenteve financiare. Këto përfshijnë: miratimin e një kuadri ligjor për buxhetimin e gjelbër; ngritjen e strukturave të përhershme për koordinimin ndër-institucional; forcimin e kapaciteteve në nivel vendor; krijimin e një Fondi Kombëtar për Mjedisin dhe Klimën; si dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit, raportimit dhe transparencës buxhetore. Duke konkluduar, afirmohet se ky raport synon tentoi të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi mënyrën se si Shqipëria ka reflektuar angazhimet e saj klimatike dhe mjedisore në praktikën reale të buxhetimit, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor. Përmes analizës së dokumenteve buxhetore, të dhënave fiskale dhe alokimeve sektoriale, raporti ndihmon në kuptimin e përputhshmërisë midis politikave të shpallura dhe burimeve të dedikuara financiare. Në këtë mënyrë, ai synon të kontribuojë në një debat më të informuar mbi sfidat dhe mundësitë që lidhen me buxhetimin e gjelbër në Shqipëri, si një përbërës i rëndësishëm i tranzicionit të qëndrueshëm dhe të drejtë.

2. Metodologjia

Ky studim bazohet në një qasje të integruar metodologjike, që kombinon analiza cilësore dhe sasiore për të vlerësuar se si Shqipëria ka buxhetuar angazhimet e saj në kuadër të Axhendës së Gjelbër. Qëllimi është të shqyrtohet përputhshmëria ndërmjet objektivave politike të shpallura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe planifikimit real buxhetor, përfshirë burimet e brendshme dhe financimet nga donatorët. Analiza fokusohet në integrimin e prioriteteve të gjelbra në ndarjet buxhetore dhe në ciklin e planifikimit fiskal, si dhe në identifikimin e boshllëqeve dhe sfidave.

Në fazën përgatitore, është realizuar një hulumtim i dokumentacioneve të ndryshme (*desk research*), i cili përfshin analizën e dokumenteve zyrtare si buxhetet vjetore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë për periudhën 2022-2024, si dhe Planifikimi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, për të gjykuar edhe në prespektivën afatmesme të programeve dhe instrumentave përkatës.

Analiza cilësore është përdorur për të vlerësuar nivelin e integritit të objektivave klimatike në politikat dhe praktikat kombëtare, si dhe për të identifikuar boshllëqet ekzistuese në strukturat institucionale dhe kapacitetet administrative. Kjo analizë ka përfshirë ndërtimin e një matrice krahasuese ndërmjet objektivave strategjikë të

deklaruar dhe realizueshmërisë, me qëllim evidentimin e shkallës së koherencës dhe identifikimin e fushave me progres të ulët ose zbatim të fragmentuar.

Në aspektin sasiore, janë përdorur metoda të analizës statistikore deskriptive për të evidentuar tendencat e alokimeve buxhetore sipas funksioneve ekonomike relevante si energjia e rinovueshme, eficienta energjetike, mbrojtja e mjedisit, transporti i qëndrueshëm dhe ekonomia qarkulluese. PBA-të janë analizuar jo vetëm si dokumente të planifikimit fiskal, por edhe si instrumente që mund të përdoren për etiketimin e politikave klimatike dhe mjedisore, në mungesë të një sistemi të institucionalizuar për *green tagging*.

Vlerësimi i shkallës së zbatimit të angazhimeve është mbështetur në një shkallë të modifikuar të vlerësimit Likert me pesë nivele, që variojnë nga mungesa e plotë e progresit (niveli 1) deri te zbatimi i plotë në përputhje me standardet e BE-së (niveli 5). Kjo shkallë është aplikuar për të matur progresin në përmbushjen e objektivave të Axhendës së Gjelbër në funksion të të dhënave dhe burimeve të disponueshme.

Në përputhje me Klasifikimin e BE-së për aktivitetet e qëndrueshme (taksonomia), studimi merr parasysh gjashtë objektiva mjedisorë: zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtja e burimeve ujore,

kalimi në ekonomi qarkulluese, parandalimi i ndotjes dhe ruajtja e biodiversitetit. Taksonomia është trajtuar si një mjet i rëndësishëm për harmonizimin e politikave dhe integrimin e standardeve të BE-së në legjislacionin shqiptar, në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Në përfundim, metodologjia e ndjekur synon të ndërtojë një analizë të strukturuar dhe të përdorshme për hartimin e politikave publike të bazuara në prova dhe për të përmirësuar më tej procesin e buxhetimit të gjelbër në Shqipëri. Kjo përfshin zhvillimin e një metodologjie të standardizuar për etiketimin e shpenzimeve klimatike, integrimin e objektivave të Axshendës së Gjelbër në të gjithë ciklin buxhetor (planifikim-zbatim-monitorim-raportim), forcimin e strukturave institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe raportimin e shpenzimeve të gjelbra, si dhe sigurimin e transparencës së plotë në përdorimin e fondeve publike dhe ndihmave ndërkombëtare.

3. Korniza Strategjike dhe Ligjore për Axhendën e Gjelbër në Shqipëri

Përballë sfidave të ndërlidhura me ndryshimet klimatike, degradimin e mjedisit dhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të qartë për të ndërtuar një kornizë strategjike dhe ligjore që harmonizohet me parimet e Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor¹ dhe objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër të Bashkimit Evropian². Kjo kornizë synon ta orientojë vendin drejt një modeli zhvillimi me emetime të ulëta karboni, efikasitet më të lartë energjetik, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe përfshirjen sociale, duke integruar strategjitë kombëtare për energjinë, mjedisin dhe ndryshimet klimatike me reforma ligjore dhe institucione përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e këtyre politikave. Ky seksion synon të analizojë në mënyrë kritike koherencën dhe aftësinë e zbatimit të kësaj kornize, duke identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe duke ofruar rekomandime për forcimin e buxhetimit të gjelbër dhe tranzicionit klimatik në Shqipëri. E gjitha kjo duke u mbështetur te legjislacioni dhe dokumentet strategjike zyrtare të Shqipërisë për zhvillimin, me objektiva të qarta e të matshme.

Po ashtu do të mbështetet te Plani i Veprimit i Axhendës (2021–2030) të RCC-së³ si dhe në Raportin e Progresit për vitin 2023 për zbatimin e Green Agenda për Ballkanin Perëndimor.

3.1

KUADRI STRATEGJIK

Shqipëria, si një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për ndërtimin e një kuadri strategjik dhe ligjor në përputhje me Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Marrëveshjen e Parisit për Klimën⁴, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG) dhe *acquis communautaire* të BE-së (European Commission, 2024). Megjithatë, përkundër progresit në nivel strategjik dhe normativ, sfidat e mëdha vazhdojnë të ekzistojnë në zbatimin praktik, monitorimin dhe integrimin e prioriteteve klimatike në politikat dhe buxhetimin publik.

Në nivel Kombëtar, dokumenti më gjithëpërfshirës për zhvillimin afatgjatë është:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2030⁵, e cila vendos si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, përafrimin me *acquis comunitare* të BE-së dhe ruajtjen e ekosistemeve. Strategjia nënvizon rëndësinë e integritit ndërsektorial dhe qeverisjes së mirë, duke theksuar nevojën për transparencë dhe pjesëmarrje qytetare.

Një tjetër strategji kyçe është **Strategjia Kombëtare për Klimën dhe Energjinë 2024–2030**⁶, e cila është harmonizuar me Marrëveshjen e Parisit dhe Komunitetin e Energjisë. Ajo përfshin objektiva për reduktimin e gazeve serë, rritjen e energjisë së rinovueshme dhe masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në sektorët strategjikë si bujqësia dhe uji.

-Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (i rishikuar) 2024–2030⁷, përputhet me strukturën e kërkuar nga BE dhe adreson pesë fusha prioritare: dekarbonizimi, efikasiteti energjetik, siguria energjetike, integrimi në tregun evropian të energjisë dhe kërkimi shkencor (*Climate Action Network Europe, 2022*)⁸. Megjithatë, kapacitetet teknike dhe institucionale janë ende të kufizuara për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre politikave⁹.

I.

Dokumenti **“Mbi Politikën e Sektorit të Pyjeve në Shqipëri” 2030** i cili thekson se menaxhimi i pyjeve bëhet nga qeverisja lokale (Bashkitë), përveç rreth 15% të fondit pyjor që

janë Zona të Mbrojtura. Dokumenti synon: Rritjen e fondit pyjor me 11 milion m³ dhe rigjenerimin e tyre; Krijimin e një strukture institucionale efikase nga qendra në nivel lokal; Ofrimin e shërbimeve efikase për mbrojtjen, përmirësimin dhe rigjenerimin e pyjeve.

II.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015 – 2030, synon të sigurojë hartimin dhe zbatimin e kornizave për zhvillim hapësinor të territorit shqiptar. Krahas zhvillimit të territorit dhe ekonomisë së vendit, plani sugjeron fuqishëm përmirësimin e mjedisit dhe ruajtjen e resurseve natyrore të vendit.

Dokumenti **i politikave strategjike dhe plani kombëtar i menaxhimit të integruar të mbetjeve 2020-2035** ¹⁰ i cili është një nga dokumentat më thelbësorë në fushën e mbetjeve që synon kalimin nga ekonomia lineare në atë qarkulluese. Fokusi i tij është të ndërlidhë gjithë aktorët dhe operatorët që përfshihen në këtë cikël me qëllim përmbytjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në shëndetin e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

-Ligji nr. 69/2024 ¹¹, “për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, për menaxhimin e integruar të mbetjeve i cili është përafruar pjesërisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”, e cila shfuqizon disa direktiva ¹². Projekt ligji nr. /2024 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” ka për qëllim ngritjen e një sistemi të menaxhimit të integruar të mbetjeve që garanton mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut dhe që mundëson tranzicionin në modelin e ekonomisë qarkulluese ¹³. Si dhe një sërë ligjesh të tjera si: Ligj Nr. 68/2023 për disa shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar;

Box 1. Objektivat mjedisor të Shqipërisë në kuadër të Marrveshjes së Parisit ¹⁴

Në përputhje me Marrëveshjen e Parisit, Axhendën e Gjelbër dhe taksonominë e BE-së, Shqipëria ka përcaktuar objektiva mjedisorë që përfshijnë uljen e emetimeve me 20.9% deri në vitin 2030 si dhe rritjen e energjisë së rinovueshme mbi 42%. Përmes Planit Kombëtar të Adaptimit 2022–2030 synohet forcimi i reziliencës ndaj përmbytjeve, thatësirave dhe fenomeneve ekstreme. Ndërsa në fushën e ujërave prioritet mbetet menaxhimi i qëndrueshëm dhe zbatimi i Direktivës Kuadër për Ujërat. Vendi ynë angazhohet gjithashtu për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese, me synimin që deri në vitin 2035 riciklimi i mbetjeve urbane të arrijë në 55%. Për uljen graduale të ndotjes së ajrit dhe forcimin e kuadrit rregullator, si dhe për zgjerimin e zonave të mbrojtura në 21% të territorit dhe restaurimin e habitateve të degraduara. Këto objektiva synojnë koherencë mes politikave mjedisore dhe planifikimit buxhetor, duke u integruar në të gjithë ciklin fiskal të vendit.

Shfrytëzimi i pasurive natyrore dhe përdorimi i tokës në Shqipëri karakterizohen nga një dinamikë intensive dhe shpesh konfliktuale. Sipas të dhënave të mbulesës tokësore (Corin LC, 2018), rreth 24% e territorit përbëhet nga tokë bujqësore, 36% nga sipërfaqe pyjore, 16% kullota dhe pjesa tjetër nga zona urbane, të degraduara ose ujore. Ndërhyrjet për qëllime ekonomike, industriale dhe infrastrukturore kanë çuar në fragmentimin e habitateve natyrore, duke rrezikuar ruajtjen afatgjatë të balancës mjedisore dhe duke sfiduar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, kuadri ligjor mbi mbrojtjen e natyrës dhe ambientin luan një rol kyç në zbatimin e politikave klimatike dhe të Axhendës së Gjelbër. Një nga sektorët ku janë ndërmarrë reforma të rëndësishme është ai i energjisë dhe eficiencës energjetike. Që prej vitit 2015, ky sektor ka njohur përparime të konsiderueshme në reduktimin e humbjeve në rrjet, përmirësimin e nivelit të faturimit dhe rritjen e prodhimit nga operatorë privatë.

Megjithatë, për të përmbushur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të avancuar në drejtim të tranzicionit të gjelbër, është e nevojshme forcimi i mëtejshëm i bazës ligjore. Kjo nënkupton një kornizë të konsoliduar, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar ndërinstitucionalisht, që siguron zbatueshmëri efektive dhe përafrim me standartet e Bashkimit Evropian.

Tabela 1. Legjislacionit mbi qëndrueshmërinë, energjinë dhe mjedisin në Shqipëri

Makrotema	Ligji	Shpjegimi i Ligjit	Rezultatet/konsekuencat
Energji e Rinovueshme	Ligji nr. 24/2023 ¹⁵	Ligj i ri që zëvendëson Ligjin nr. 7/2017. Synon rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë për një zhvillim të qëndrueshëm, uljen e gazeve serrë dhe reduktimin e varësisë nga burimet fosile. Përafruar me Direktivën (BE) 2018/2001.	Rritje e prodhimit dhe konsumit të energjisë së rinovueshme; bashkëpunim ndërkombëtar; lehtësi për vetëkonsumatorët; mbikëqyrje dhe masa korrigjuese nga MIE nëse nuk arrihen objektivat deri në 2027.
Për performancën energjetike të ndërtesave	Ligji nr. 37, dt. 16.6.2025 ¹⁶	Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën (BE) 2024/1275 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 Prill 2024 “Për performancën energjetike të ndërtesave”.	Ky ligj synon transformimin rrënjësor të mënyrës se si ndërtohen dhe rinovohen ndërtesat në Shqipëri, me objektivin që deri në vitin 2050, të gjitha godinat, publike dhe private të kthehen në ndërtesa me konsum minimal energjie.
Eficienca e energjisë dhe informimi i konsumatorit	Ligji nr. 52/2024 ¹⁷	Vendos standarde për etike timin e produkteve me ndikim në energji për konsumatorin. Transpozon rregulloren e BE-së 2017/1369 dhe përputhet me strategjitë kombëtare. Shfuqizon Ligjin nr. 68/2012.	Transparencë më e lartë për konsumatorët; promovim i produkteve më efikente; ulje e konsumit total të energjisë; klasifikim i ri energjie A-G.
Politikat kombëtare të eficiencës	Ligji nr. 124/2015 ¹⁸	Përcakton objektiva kombëtare për eficiencën energjetike dhe heq pengesat në treg; krijon Agjencinë për Eficiencën e Energjisë. Përafruar me Direktivën 2012/27/BE.	Zhvillim i profesionistëve të fushës; strategji për kursimin e energjisë; më shumë instrumente ligjore dhe teknike për menaxhimin e eficiencës.

Mbrojtja gjithëpërfshirëse e mjedisit	Ligji nr. 10 431/2011 19	Ligji bazë për mbrojtjen e mjedisit. Parashikon mbrojtjen e ajrit, tokës, ujit dhe natyrës si dhe përcakton strategjitë dhe përgjegjësitë ndërinstitucionale. Përafruar me Direktivën 2004/35/KE.	Krijimi i AKM; detyrimi për strategji kombëtare dhe vendore; ndarje lejesh tip A dhe B për aktivitetet ndotëse.
Ndikimi në Mjedis	Ligji nr. 10 440/2011 20	Krijon kornizë për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private përpara miratimit të tyre. Parashikon vlerësime paraprake dhe të thelluara, konsultim publik dhe lëshim të deklaratave mjedisore nga ministria e linjës. Përafruar plotësisht me Direktivën 85/337/KEE të BE.	Përmirësim i transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut; forcim i kontrollit mbi ndikimin në mjedis të projekteve të reja; adresim i mungesës së koordinimit ndërinstitucional dhe vetmonitorimit të subjekteve.
Lejet Mjedisore	Ligji nr. 10 448/2011 21	Vendos rregullat për dhënien e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B për veprimtari ndotëse. Përqendron autoritetin te AKM dhe Ministri i linjës. Heq lejet e tipit C dhe përcakton sanksione më të forta për mosrespektim. Përafruar me direktivat 2008/1/KE dhe 2001/80/KE.	Forcon kontrollin institucional; redukton ndotjen industriale; rrit transparencën dhe efikasitetin e lejeve; integron teknikat më të mira të disponueshme (TMD).
Ndryshimet Klimatike	Ligji nr. 155/2020 22	Krijon kuadër kombëtar ligjor dhe institucional për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Përfshin hartimin e dokumentit NDC dhe mekanizma të raportimit, monitorimit dhe verifikimit. Përafruar me Direktivën 2003/87/KE dhe Rregulloren (BE) nr. 525/2013.	Zbatimi i masave për reduktimin e gazeve me efekt serrë; përfshirje e sektorëve publik dhe privat në politikat klimatike; inkurajim i investimeve të gjelbra dhe zhvillim i strategjive afatgjata klimatike.

Gaze Serrë të Fluoruar	Ligji nr. 2/2023	Rregullon prodhimin, përdorimin, tregtimin dhe trajtimin e gazrave serrë të fluoruar dhe pajisjeve që i përmbajnë ato. Në zbatim të Amendamentit Kigali. Vendosi kufizime të reja nga viti 2025.	Reduktim i ndikimit klimatik të F-gazrave; krijimi i kushteve për treg të kontrolluar dhe të certifikuar; masa licencimi dhe trajnimi për operatorët.
Mbetjet dhe Menaxhimi i Tyre	Ligji nr. 10 463/2011	Parashikon menaxhim të integruar të mbetjeve në përputhje me parimin 'ndotësi paguan'. Ndalon importin e mbetjeve dhe promovon partneritetin publik-privat. Përafruar me Direktivën 2008/98/KE.	Ulja e rrezikut për mjedisin dhe shëndetin; zhvillim i infrastrukturës për përpunim dhe riciklim; tranzicion drejt një ekonomie qarkulluese.
Ndikimi në Mjedis	Ligji nr. 10 440/2011	Krijon kornizë për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private përpara miratimit të tyre. Parashikon vlerësime paraprake dhe të thelluara, konsultim publik dhe lëshim të deklaratave mjedisore nga ministria e linjës. Përafruar plotësisht me Direktivën 85/337/KEE të BE.	Përmirësim i transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut; forcim i kontrollit mbi ndikimin në mjedis të projekteve të reja; adresim i mungesës së koordinimit ndërinstitutional dhe vetmonitorimit të subjekteve.
Lejet Mjedisore	Ligji nr. 10 448/2011	Vendosi rregullat për dhënien e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B për veprimtari ndotëse. Përqendron autoritetin te AKM dhe Ministri i linjës. Heq lejet e tipit C dhe përcakton sanksione më të forta për mosrespektim. Përafruar me direktivat 2008/1/KE dhe 2001/80/KE.	Forcon kontrollin institucional; redukton ndotjen industriale; rrit transparencën dhe efikasitetin e lejeve; integron teknikat më të mira të disponueshme (TMD).
Ndryshimet Klimatike	Ligji nr. 155/2020	Krijon kuadër kombëtar ligjor dhe institucional për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Përfshin hartimin e dokumentit NDC dhe mekanizma të raportimit, monitorimit dhe verifikimit. Përafruar me Direktivën 2003/87/KE dhe Rregulloren (BE) nr. 525/2013.	Zbatimi i masave për reduktimin e gazeve me efekt serrë; përfshirje e sektorëve publik dhe privat në politikat klimatike; inkurajim i investimeve të gjelbra dhe zhvillim i strategjive afatgjata klimatike.

Gaze Serrë të Fluoruar	Ligji nr. 2/2023 ²³	Rregullon prodhimin, përdorimin, tregtimin dhe trajtimin e gazrave serrë të fluoruar dhe pajisjeve që i përmbajnë ato. Në zbatim të Amendamentit Kigali. Vendos kufizime të reja nga viti 2025.	Reduktim i ndikimit klimatik të F-gazrave; krijimi i kushteve për treg të kontrolluar dhe të certifikuar; masa licencimi dhe trajnimi për operatorët.
Mbetjet dhe Menaxhimi i Tyre	Ligji nr. 10 463/2011 ²⁴	Parashikon menaxhim të integruar të mbetjeve në përputhje me parimin ‘ndotësi paguan’. Ndalon importin e mbetjeve dhe promovon partneritetin publik-privat. Përafruar me Direktivën 2008/98/KE.	Ulja e rrezikut për mjedisin dhe shëndetin; zhvillim i infrastrukturës për përpunim dhe riciklim; tranzicion drejt një ekonomie qarkulluese.
Cilësia e Ajrit	Ligji nr. 162/2014 ²⁵	Përcakton standardet për cilësinë e ajrit në ambient dhe integron mbrojtjen e ajrit në politikat e tjera. Parashikon vlerësim, monitorim dhe raportim të ndotësve në ajër, si dhe pjesëmarrje të publikut në hartimin e planeve për cilësinë e ajrit. Përafruar me Direktivën 2008/50/KE dhe 2004/107/KE.	Kontroll më i mirë i ndotjes së ajrit; rritja e ndërgjegjësimit publik; përmirësim i shëndetit publik dhe integrim me standardet europiane për ajrin.
Menaxhimi i Kimikateve	Ligji nr. 27/2016 ²⁶	Synon mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga kimikatet e rrezikshme; promovon metoda alternative dhe ndalon përdorimin e substancave të rrezikshme. Parashikon krijimin e Zyrës së Kimikateve dhe transponon Rregulloret REACH (1907/2006) dhe CLP (1272/2008).	Reduktim i ekspozimit ndaj substancave të rrezikshme; rritje e sigurisë në tregun e kimikateve; kontroll dhe informacion i përmirësuar për operatorët ekonomikë.

Tabela 2. Konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare në fushën e mjedisit

Instrumenti Ndërkombëtar	Viti	Përshkrimi dhe Objektivat Kryesore	Statusi në Shqipëri
Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Shkretëtirëzimit (UN-CCD)	1994	Promovon arritjen e Neutralitetit të Degradimit të Tokës (NDT) deri në 2030 përmes ripyllëzimit, pyllëzimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tokës në zona të ndjeshme ndaj erozionit.	Shqipëria është palë dhe ka përcaktuar objektiva konkrete kombëtare.
Konventa e Aahrusit	1998	Forcon transparencën mjedisore duke garantuar: - Qasje publike në informacion; - Pjesëmarrje në vendimmarrje; - Akses në drejtësi për çështje mjedisore.	Nënshkruar më 25 qershor 1998, hyri në fuqi në Shqipëri më 27 qershor 2001.
Konventa për Larminë Biologjike (CBD)	1992	Promovon ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të tij dhe shpërndarjen e drejtë të përfitimeve nga burimet gjenetike.	Shqipëria e ratifikoi më 5 janar 1994 pas Samitit të Tokës në Rio.
Konventa e Bernit	1979	Synon ruajtjen e specieve të egra dhe habitatit natyror, duke ndaluar ndërhyrjet që dëmtojnë biodiversitetin në Evropë.	Shqipëria e ratifikoi më 4 prill 1998.
Marrëveshja e Parisit për Klimën	2015	Qëllimi është reduktimi i ndjeshëm i emetimeve të gazrave serrë dhe përfshirja e shteteve në veprim klimatik global.	Shqipëria e ratifikoi më 21 shtator 2016.
Direktiva e Habitatit (92/43/EEC)	1992	Krijon rrjetin ekologjik NATURA 2000, për të mbrojtur habitatet natyrore dhe speciet e florës dhe faunës së egër.	Shqipëria e ka transpozuar pjesërisht në ligjin kombëtar për zonat e mbrojtura.
Direktiva e Shpendëve (2009/147/EC) (zëvendëson 79/409/EEC)	2009	Mbron shpendët e egër dhe habitatet e tyre; vendos themelin për Zonat e Rëndësishme për Shpendët (SPA).	Shqipëria ka nisur përputhjen përmes monitorimit të specieve dhe identifikimit të zonave IBA për NATURA 2000.

Në përmbyllje, jepet lidhja e objektivave mjedisore me ciklin buxhetor, duke u mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues dhe në praktikat e integrimit tematik tashmë të provuara. Baza është Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” ²⁷, i cili përcakton klasifikimin programor (program–nënprogram–projekt) dhe mundëson krijimin e “fondeve speciale” me ligj, të cilat janë gjithmonë të balancuara; brenda kësaj “strukture”, etiketimi buxhetor “green” mund të realizohet duke u regjistruar në formatet dhe sistemet e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe duke u pasqyruar në ligjin vjetor të buxhetit përmes një aneksi përmbledhës të shpenzimeve të etiketuara si mjedis/klimë. Procedurat praktike dhe formatet standarde të PBA rregullohen nga Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ²⁸, i cili shërben si udhëzim i përhershëm për përgatitjen e PBA-së dhe vendos bazën operacionale për vendosjen e fushave të reja të raportimit (p.sh., një fushë “axhenda e gjelbër” në nivel programi/nënprogrami/projekti).

Dicka e ngjashme është bërë me buxhetimin gjinor: VKM nr. 465, datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në PBA” ²⁹ dhe Udhëzimi i përbashkët nr. 21, datë 21.06.2013 ³⁰ “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në PBA”. Ky mekanizëm etiketimi/raportimi mund të adoptohet në mënyrë të ngjashme për të bërë të njëjtën gjë me etiketimin e shpenzimeve “green”. Po ashtu, duke qenë se ligji nr. 9936 (neni 7) ³¹ lejon krijimin e fondeve speciale, mund të rekomandohet krijimi i një fondi për “Axhendën e gjelbër” pasi mbështetet juridikisht. Fondi mund të krijohet me ligj të posaçëm, të integrohet në ligjin vjetor të buxhetit dhe të raportojë periodikisht performancën kundrejt objektivave mjedisore e klimatike, në koherencë me etiketimin “green”.

SFIDAT MJEDISORE DHE INTEG- RIMI I OBJEKTIVAVE KLIMATIKE NË PROCESIN BUXHETOR

Ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim të madh global me ndikime komplekse mbi të gjitha aspektet e jetës në Tokë, përfshirë mjedisin, ekonominë dhe shëndetin publik (Van Leeuwen et al., 2024; Dow & Downing, 2016; Richardson, Steffen & Liverman, 2011). Aktivitetet njerëzore si përdorimi i lëndëve djegëse fosile dhe shpyllëzimi kanë përshpejtuar efektin serë dhe ngrohjen globale, me dekadën 2011–2020 të regjistruar si më e nxehta deri më tani (IPCC, 2021; NASA, 2022). Kjo rritje e temperaturave, nëse kalon kufirin prej 2°C, mund të shkaktojë pasoja serioze dhe të pakthyeshme në ekosistemet dhe jetën e njeriut. Shqipëria, për shkak të pozitës së saj gjeografike dhe karakteristikave klimatike, konsiderohet veçanërisht e ndjeshme ndaj këtyre ndryshimeve (EEA, 2017; UNEP, 2021), me efekte që tashmë ndihen në formën e thatësirave, përmbytjeve dhe variacioneve të reshjeve. Sektori i bujqësisë është veçanërisht i goditur, duke vuajtur nga pasiguria e reshjeve, thatësira dhe erozioni i tokës, çka ka sjellë rënie në rendimentet dhe rritje të varësisë nga importet (INSTAT, 2023; Sandström et al., 2024; Manduna, 2024; FAO, 2020; Calzadilla et al., 2013). Për më tepër, menaxhimi i dobët i tokës dhe mungesa e teknologjive të qëndrueshme thellojnë dobësitë strukturore të sektorit (Zhllima et al., 2022; 2024; Kucaj et al., 2024).

Kjo ndoshta është dhe arsyeja pse në dekadat e fundit, ndryshimet klimatike janë kthyer në një sfidë globale që kërkon reagim të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës nga qeveritë. Për të kaluar te kostot dhe sfidat reale të Shqipërisë, referuar raportit të Bankës Botërore (2024) rezulton se ndryshimet klimatike si: mungesa e reshjeve dhe thatësirat, apo rreshjet e dendura në periudha thatësire, mund të ulin prodhimin e energjisë elektrike nga HEC deri në 50% dhe të shkaktojnë humbje bujqësore të konsiderueshme. Në mungesë të masave për të frenuar ndryshimet klimatike, ky raport referon se dëmet vjetore të pritshme do të rriten në ~7,2% të PBB-së në vitin 2050 [32](#). Masat në fjalë kushtojnë rreth 6 miliardë dollarë për dekadën e ardhshme, që përbën rreth 0.6–1 % të GDP-së vjetore deri në 2050. Në këtë kontekst, buxhetimi i gjelbër (*green budgeting*) është shfaqur si një instrument thelbësor për të integruar objektivat mjedisore dhe klimatike në procesin e planifikimit dhe zbatimit të politikave fiskale.

Green budgeting është praktikë relativisht e re, jo plotësisht e standardizuar dhe me qasje heterogjene mes vendeve. BE-ja ka zhvilluar EU Green Budgeting Reference Framework (GBRF) për vendet anëtare, e cila shërben si një “*basic toolkit*” për Shtetet Anëtare që duan ose të nisin zbatimin e buxhetimit të gjelbër, ose të përmirësojnë praktikën e tyre aktuale, duke shërbyer kështu si udhëzues për

kornizat kombëtare të buxhetimit të gjelbër ³³. Ndërsa OECD ka propozuar një kornizë mbi mënyrën e zbatimit të buxhetimit të gjelbër, e cila përbëhet nga katër shtylla kryesore: (i) planifikimi strategjik dhe fiskal; (ii) mjetet e buxhetimit për gjenerimin e evidencës dhe koherencën e politikave; (iii) llogaridhënia dhe transparenca; (iv) një mjedis i favorshëm për buxhetimin. OECD përkrah kornizën me katër “shtylla” (institucione, metoda/mjete, raportim, mjedis mundësues) ³⁴. Këto dy referenca shpjegojnë pse zgjidhjet ndryshojnë sipas kapaciteteve dhe objektivave kombëtare. Përsa i përket zbatimit, referuar një raporti të OECD, shumica e vendeve të OECD-së kanë futur në përdorim praktikën e buxhetimit të gjelbër. Numri i vendeve që po prezantojnë praktika të buxhetimit të gjelbër po rritet me shpejtësi, nga 14 vende që ishin në vitin 2020, në 24 vende në vitin 2022 ³⁵.

Sipas UE ³⁶, buxhetimi i gjelbër është praktika e integritit të konsideratave mjedisore në të gjithë procesin buxhetor publik, për të përafruar buxhetet dhe politikat kombëtare me objektivat mjedisore, siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane. Kjo përfshin identifikimin, vlerësimin dhe, nëse është e nevojshme, ridrejtimin e zërave buxhetorë për të mbështetur objektivat mjedisore, duke vlerësuar ndikimin e tyre në mjedis dhe duke përshtatur shpenzimet publike.

Integrimi i objektivave klimatike në buxhetimin publik ndihmon në rritjen e transparencës, eficiencës dhe përgjegjshmërisë së politikave qeveritare ³⁷. Në Shqipëri, ndonëse janë ndërmarrë disa hapa drejt identifikimit të shpenzimeve klimatike, mungon ende një sistem i formalizuar dhe i strukturuar për “green tagging”, pra për etiketimin dhe kategorizimin e shpenzimeve buxhetore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në klimë dhe mjedis. Kjo mangësi e pengon vendin të ketë një kuadër të qartë për të vlerësuar përputhshmërinë e politikave publike me objektivat klimatike afatgjata ³⁸. Referuar raportit të përgatitur nga Westminster Foundation for Democracy (WFD) në vitin 2022, Shqipëria ka bërë përparim në nivel strategjik, duke përfshirë çështjet e klimës në dokumente si Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, por këto politika nuk janë të përkthyer ende në mekanizma konkretë buxhetorë. Raporti nënvizon mungesën e një metodologjie standarde për green tagging, mungesën e kapaciteteve institucionale dhe mungesën e një procesi të mirëkoordinuar ndër-institucional.

Shqipëria ka gjithashtu detyrime të rëndësishme që burojnë nga procesi i integritit evropian. Hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian në korrik të vitit 2022 ka rritur presionin për përmbushjen e standardeve të kapitullit 27 ³⁹, i cili trajton politikat e mjedisit dhe klimës.

BUXHETIMI I EKONOMISË SË GJELBËR NË SHQIPËRI

Integrimi i buxhetimit të gjelbër konsiderohet si një hap i domosdoshëm për përputhshmërinë me *acquis communautaire* dhe për të përfituar nga instrumentet financiare të BE-së për tranzicionin e gjelbër (EU-4Green, 2025). Referuar një raporti të OECD-së për green budgeting ⁴⁰ si dhe raportit të WFD (2022) rezulton se Shqipëria përballët me disa sfida të rëndësishme në rrugën drejt buxhetimit të gjelbër. Fragmentarizimi institucional, mungesa e të dhënave të detajuara për ndikimin e shpenzimeve në klimë, si dhe mungesa e ekspertizës së specializuar janë ndër pengesat kryesore. Për të tejkaluar këto sfida, është e nevojshme një qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse që përfshin: Hartimin e një metodologjie kombëtare për identifikimin dhe etiketimin e shpenzimeve të gjelbra; Miratimin e një kuadri ligjor që detyron integrimin e klimës në procesin e buxhetimit; Krijimin e strukturave të posaçme në Ministrinë e Financave; Trajnimin e vazhdueshëm të stafit administrativ dhe forcimin e kapaciteteve institucionale; Përfshirjen e buxhetimit të gjelbër në dokumentet afatmesme të shpenzimeve dhe në ciklin e planifikimit buxhetor vjetor. Aktivizimin e instrumenteve financiare si green bonds dhe financime të përziera publike-private për investime të qëndrueshme.

Në ligjin organik të buxhetit të shtetit dhe ligjet e tjera të lidhura me të, ende nuk gjendet përkufizimi “Buxhetimi i gjelbër”⁴¹. Ky kufizim e bën të vështirë analizën sasiore të fondeve buxhetore për ekonominë e gjelbër por, si qasje më e përshtatshme institucionale dhe në ndjekje të shpenzimeve buxhetore lidhur me ekonominë e gjelbër, mund të gjykojmë mbi alokimin e fondeve tek institucionet përgjegjëse për mjedisin dhe klimën në Shqipëri, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas shpenzimeve klasifikimit funksional dhe programeve të lidhura me ekonominë e gjelbër.

Duke ju referuar të dhënave buxhetore për MTM, vihet re se planifikimi buxhetor afatmesëm ka tendencë të reduktojë portofolin e ministrisë. Për vitin 2025 parashikohet një fond prej 3,975 milionë Lekë, ndërkohë që për vitin 2027 ky fond është 3,548 milionë Lekë. Trendi rënës vihet re jo vetëm në vlerë por dhe si raport ndaj PBB dhe ndaj shpenzimeve të përgjithshme buxhetore. Të dhënat jepen në Tabelën 4.

Tabela 4. Alokimi i fondeve buxhetore për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit sipas PBA

Treguesi	2024	2025	2026	2027
Në % ndaj PBB	0.14%	0.15%	0.14%	0.12%
Në % ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë	0.46%	0.48%	0.46%	0.40%
Në vlerë nominale (Mln lekë)	3,523	3,975	3,880	3,548

Burimi: Relacioni PBA 2025-2027

MTM implementon 5 programe kryesore:

Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi;

Administrimi i Pyjeve;

Zhvillimi i Turizmit;

Mbrojtja e Mjedisit dhe;

Menaxhimi i Mbetjeve Urbane (i shtuar në vitin 2024).

Shpenzimet faktike për këto programe janë rritur nga rreth 2,106 milionë Lekë në vitin 2022, në rreth 2,695 milionë Lekë në vitin 2024. Programi për Mbrojtjen e Mjedisit zinte dhe portofolin kryesor në vitin 2022, me rreth 838 milion Lekë, por është reduktuar në 737.7 milionë lekë në vitin 2024.

Në vitin 2024 pjesën më të madhe të portofolit të shpenzimeve për këtë ministri e zë programi Zhvillimi i Turizimit, i cili ka arritur edhe financimin më të madh në vitin 2023 me 948.6 milion lekë. Trend rritës shfaq edhe programi Administrimi i Pyjeve gjatë gjithë periudhës 2022-2024.

Duke u rikthyer tek Mbrojtja e Mjedisit, gjatë periudhës 2022- 2024, vihet re se shpenzimet korrente janë me trend rritës, për të arritur në 444.1 milionë Lekë në vitin 2024. Shpenzimet kapitale janë reduktuar ndjeshëm gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022, por kanë një rritje në vitin 2024. Gjithsesi, rritja e vitit 2024 nuk arrin nivelin e shpenzimeve kapitale të vitit 2022, me një diferencë të theksuar prej -166.4 milionë lekë në financimin e huaj. Për më tepër informacion të konsultohet Tabela 5.

Tabela 5. Shpenzimet buxhetore faktike për programet e MTM 2022-2024

Treguesi	Shpenzimet Korrente	Shpenzimet kapitale		Total
		Fin. i Brend-shëm	Fin. i Huaj	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administ.	212,073	1,704	-	211,753
Administrimi i Pyjeve	320,008	34,904	-	354,912
Zhvillimi i Turizmit	316,756	367,580	15,102	699,438
Mbrojtja e Mjedisit	351,698	130,007	356,377	838,082
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	-	-	-	-
MTM 2022 (mijë lekë)	1,200,535	(i pritshëm)	(i pritshëm)	(i pritshëm)
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administ.	209,552	2,201	-	211,753
Administrimi i Pyjeve	409,077	45,410	-	454,487
Zhvillimi i Turizmit	516,545	413,665	18,311	948,521
Mbrojtja e Mjedisit	427,337	96,266	24,471	548,075
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	-	-	-	-
MTM 2023 (mijë lekë)	1,562,511	557,543	42,782	2,162,836
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administ.	249,950	1,600	-	251,550
Administrimi i Pyjeve	478,800	279,760	-	758,560
Zhvillimi i Turizmit	835,400	15,350	600	851,350
Mbrojtja e Mjedisit	444,110	103,611	190,000	737,721
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	16,000	29,747	50,000	95,747
MTM 2024 (mijë lekë)	2,024,260	430,068	240,600	2,694,928

Burimi: Buxheti Faktit 2022; 2023 dhe AN Dhjetor, 2024

Për vitin 2024, sipas të dhënave të disponueshme të Aktit Normativ Dhjetor 2024, MTM ka arritur të shpenzojë vetëm 76.5% të kërkesës buxhetore (fondeve të planifikuara) për vitin 2024. Për vitin 2024 ishin planifikuar rreth 3.52 Miliardë Lekë për këtë ministri, ndërkohë që ka shpenzuar vetëm rreth 2.7 Miliardë lekë.

Planifikimi i fondeve buxhetore për programet e MTM mund të gjenden në Planifikimin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027. Vihet re rritje e fondeve për vitin 2025, ndërkohë që në vitin 2027 shuma e alokuar është e përafërt me vitin 2024. Për programin Mbrojtja e Mjedisit janë alokuar 956.8 milionë lekë për vitin 2025 dhe kjo shumë mbetet pothuajse konstante edhe në periudhën pasardhëse. Dy programet që marrin rritje gjatë periudhës 2025-2026 janë Menaxhimi i mbetjeve Urbane dhe Administrimi i pyjeve, por në vitin 2027 parashikohet një reduktim i ndjeshëm i këtij të fundit.

Trend rritës shihet tek Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi, ndërkohë që Zhvillimi i Turizmit mbetet në nivele konstante gjatë 2025-2027. Për analizë më të detajuar jepet Tabela 6 e cila paraqet edhe shpenzimet e planifikuara sipas klasifikimit ekonomik. P.sh., vihet re që shpenzimet kapitale (Aktivet) pritet të rriten gjatë 2025-2026, por në vitin 2027 ato reduktohen edhe më shumë se viti 2024. Fondi i pagave zë një peshë të konsiderueshme në shpenzime gjatë gjithë periudhës, dhe pse planifikohet i qëndrueshëm, ndërsa Mallrat dhe Shërbimet tregojnë trend rritës gjatë gjithë periudhës.

Tabela 6. Alokimi i fondeve për MTM sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik

Kodi	Programi (mijë lekë)	2024	2025	2026	2027
01110	Plan, Menaxhimi dhe Adminis.	252,950	344,727	346,727	351,727
04260	Administrimi i Pyjeve	867,560	1,079,550	1,081,050	742,050
04760	Zhvillimi i Turizmit	569,747	585,860	586,860	586,860
05220	Mbrojtja e Mjedisit	979,110	956,770	957,770	957,770
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	853,740	1,008,000	908,000	910,000
Totali		3,523,107	3,974,907	3,880,407	3,548,407
sipas klasifikimit ekonomik (mijë lekë)					
600	Pagat	947,800	1,040,699	1,040,699	1,040,699
601	Sig. Shoqërore dhe Shëndetësore	159,050	175,951	175,951	175,951
602	Mallrat dhe Shërbimet	688,458	737,458	742,458	749,458
603	Subvencione	-	-	-	-
604	Transfertë e brendshme	20,000	355,280	255,280	257,280
605	Transfertë e jashtme	1,672	20,000	20,000	20,000
606	Transfertë për individët	1,450,847	1,672	1,672	1,672
230/1	Aktivet	1,450,847	1,643,847	1,644,347	1,303,347

Burimi: Buxheti Faktit 2024 dhe PBA 2025-2027

Sipas buxhetit faktit 2023-2024 mund të analizohet tre programet kryesore që ndjek MTM; Mbrojtja e Mjedisit; Administrimi i Pyjeve dhe Zhvillmi i Turizmit ⁴². Këto të dhëna mund të detajohen më shumë dhe mund të krahasohen me PBA 2025-2027.

Programi Mbrojtja e Mjedisit në vitin 2023 janë shpenzuar rreth 553.2 milionë lekë të ndara në rreth 427.3 milionë në shpenzime

korrente dhe rreth 120.7 milionë lekë në shpenzime kapitale. Rreth 96.3 milionë lekë nga totali i shpenzimeve kapitale ka burim buxhetin qendror dhe vendor. Ndërkohë ka realizuar edhe të ardhura jashtë limit në vlerën 5.2 milionë lekë. Për vitin 2024 vlera e programit është reduktuar në vlerën 491.7 milionë lekë, ku reduktimin më të madh e tregojnë shpenzimet kapitale me një diferencë prej rreth 50 milionë lekë.

Krahasuar shpenzimet faktike 2024 me kërkesën buxhetore për 2025-2027 vihet re rritje e lartë e fondeve për këtë program. Për vitin 2025 ka një shtesë prej 465 milionë lekë, krahasuar me vitin 2024 dhe shpenzimet korrente të planifikuara janë rritur vetëm me rreth 63 milionë lekë, pjesa tjetër i përket shpenzimeve kapitale. Kjo rritje e dukshme në vitin 2025 pritet të ndodh si rezultat i financimit nga fondet e huaja me një grant prej 258 milionë lekë dhe kreditim me 132 milionë lekë.

Ndërkohë që shuma totale e grantit dhe kreditimit mbetet konstante në 390 milionë lekë gjatë 2025-2027, vlera e grantit reduktohet në 190 milionë lkeë në vitn 2027 duke lënë hapësira për rritje të kreditimit deri në vlerën 200 milionë lekë. Gjithashtu vihet re edhe rritje e pjesëmarrjes së qeverisë lokale në financimin e shpenzimeve kapitale. Për më tepër të konsultohet Tabela 7.

Tabela 7. Mbrojtja e Mjedisit, shpenzimet faktike 2023-2024 dhe PBA 2025-2027

Zërat (mijë lekë)	Buxheti Faktik		PBA		
	2023	2024	2025	2026	2027
Totali shpenzimeve të Programit	553,219	491,711	956,770	957,770	957,770
a. Shpenzime korrente	427,337	413,853	476,770	477,770	477,770
b. Shpenzime kapitale	120,737	71,661	480,000	480,000	480,000
Nga Buxheti	96,266*	56,775*	2,000	2,000	2,000
Financim i huaj - Grant	244,710	148,858	258,000	213,000	190,000
Financim i huaj - Kredi			132,000	177,000	200,000
Kosto lokale			55,845	78,000	80,000
TVSH, Detyrim Doganor			32,155	10,000	8,000
c. Nga të ardhurat jashtë limitit	5,144	6,197	-	-	-

Burimi: Buxheti Faktit 2024 dhe PBA 2025-2027
 *përmbajnë dhe shpenzimet e qeverisë vendore

Programi Administrimi i Pyjeve ka administruar një total shpenzimesh prej 604.4 milionë lekë për vitin 2024, ndër to rreth 455 milionë lekë në shpenzime korrente dhe pjesa tjetër në shpenzime kapitale. Krahasuar me faktin 2024 vihet një rritje e lartë për vitin 2025, ku pesha kryesore e rritjes mbartjet nga

shpenzimet kapitale, të cilat fiancohen tërësisht nga buxheti i shtetit. Në vitin 2027, për këtë projekt, kemi një rritje të konsiderueshme të fondeve për shpenzime korrente ndërkohë që shpenzimet kapitale reduktohen me rritjen e shpenzimeve korrente. Për më tepër, të konsultohet Tabela 8.

Tabela 8. Administrimi i Pyjeve, shpenzimet faktike 2023-2024 dhe PBA 2025-2027

Zërat (mijë lekë)	Buxheti Faktik		PBA		
	2023	2024	2025	2026	2027
Totali shpenzimeve të Programit	465,892	604,371	1,079,550	957,770	957,770
Shpenzime korrente	409,077	455,157	538,450	416,170	757,170
Shpenzime kapitale	45,410	119,353	541,100	541,600	200,600
<i>Nga Buxheti</i>	45,410	119,353	541,100	541,600	200,600
Nga të ardhurat jashtë limitit	11,404	29,861	-	-	-

Burimi: Buxheti Faktit 2024 dhe PBA 2025-2027

Përsa i përket programit Zhvillimi Turizmit, i cili ka arritur vlerën e 824.5 milionë lekë në vitin 2024, vihet re që pjesa më madhe e shpenzimeve i takon atyre korrente. Për periudhën 2025-2027 shpenzimet kapitale për këtë program luhaten në nivelin 9% të

shpenzimeve totale, ndërkohë që në vitin 2023 ato mbulonin rreth 45.5% të shpenzimeve totale. Edhe në këtë rast shpenzimet kapitale financohen totalisht nga buxheti i shtetit. Për më shumë të konsultohet Tabela 9.

Tabela 9. Zhvillimi i Turizmit, shpenzimet faktike 2023-2024 dhe sipas PBA 2025-2027

Zërat (mijë lekë)	Buxheti Faktik		PBA		
	2023	2024	2025	2026	2027
Totali shpenzimeve të Programit	948,521	824,506	1,008,000	957,770	957,770
a. Shpenzime korrente	516,545	814,057	918,000	867,770	867,770
b. Shpenzime kapitale	431,976	9,957	90,000	90,000	90,000
<i>Nga Buxheti</i>	413,665	9,440	90,000	90,000	90,000
c. Nga të ardhurat jashtë limitit	-	492	-	-	-

Burimi: Buxheti Faktit 2024 dhe PBA 2025-2027

Interesante duket dhe analiza e njësive të vetqeverisjes vendore në shpenzimet sipas klasifikimit funksional për Mbrojtjen e Mjedisit, të paraqitura në Tabelën 10. Në vitin 2024 shpenzimet për Mbrojtjen e Mjedisit kanë një rënie prej 1.4% krahasuar me vitin

2022, ndërkohë që numri i bashkive që kryejnë këtë shpenzim është rritur me 13 bashki për të njëjtën kohë krahasimi. Ndërkohë kemi vetëm 1 njësi institucionale “Qarku” që realizon shpenzime për këtë funksion. Ky është Qarku i Korçës.

Tabela 10. Qeverisja vendore për Mbrojtjen e Mjedisit, sipas klasifikimit funksional

	2022	2023	2024
Shpenzimet (Mijë, lekë)	6,035,390	6,023,044	5,948,689
Nr. i bashkive	42	51	55
Nr. i qarqeve	1	1	1

Burimi: Ministria e Financave, 2025

Bashkia me peshën më të lartë në shpenzime ndaj totalit mbetet Bashkia Tiranë, e cila zinte rreth 39.7% të shpenzimeve për vitin 2022, ndërkohë që për vitin 2024 ky tregues është reduktuar në 27.6%, ose në vlerë absolute janë shpenzuar rreth 755.2 milionë Lekë më pak për këtë bashki. Rënie në këtë shpenzim ka pësuar edhe Bashkia Durrës me rreth 4.4.% po për të njëjtën kohë krahasim, ose rreth 42.7 milionë lekë më pak. Ndërkohë që Bashkia Elbasan ka rritur ndjeshëm shpenzimet për këtë zë. Në vitin 2022 ajo shpenzonte rreth 162 milionë Lekë, ndërkohë që në vitin 2024 shpenzimet kanë arritur në 306.3 milionë Lekë.

Përsa i përket qarkut si njësi insitucionale e vetqeverisjes vendore, vetëm Qarku i Korçës ka realizuar shpenzime për Mrojtjen e Mjedisit gjatë periudhës 2022-2024. Në vitin 2022 ka realizuar rreth 0.57 milionë lekë shpenzime,

ndërkohë që në vitin 2023 ky tregues ka arritur në rreth 28.4 milionë Lekë, për tu kthyer në 0.435 milionë lekë në vitin 2024. Vlera e lartë për vitin 2023 korrespondon me mungesë shpenzimesh nga ana e Bashkisë Korçë për këtë vit.

Në nivel qarku⁴³, gjatë periudhës 2022-2024 vihet sërish re rënia në qarkun e Tiranës dhe Durrësit. Gjithashtu me rënie rezulton edhe grupi i bashkive në qarkun e Dibrës, dhe Kukësit. Ndërkohë që të gjitha qarqet e tjera kanë rritje të shpenzimeve për Mbrojtjen e Mjedisit, por rritja më e lartë vihet re në qarkun Gjirokastër me mbi 5.2 herë në krahasim 2022 me 2024. Gjithashtu rritje ka pësuar edhe Qarku i Elbasanit me rreth 65% si dhe Qarku i Korçës me gati 62.5% po për të njëjtën kohë krahasim. Të dhënat për shpenzimet e bashkive, të grupuara sipas qarkut janë paraqitur në Tabelën 11.

Tabela 11. Shpenzimet në qark për Mbrojtjen e Mjedisit, sipas klasifikimit funksional

Qarku (mijë lekë)	2022	2023	2024
Berat	142,357	140,235	181,696
Dibër	105,118	97,474	58,752
Durrës	1,075,622	1,053,584	1,003,976
Elbasan	277,291	368,750	456,840
Fier	367,161	423,977	369,287
Gjirokaštër	30,299	94,036	190,573
Korçë	173,044	117,928	281,114
Kukës	16,524	15,551	5,950
Lezhë	116,884	129,756	161,686
Shkodër	275,275	301,841	328,459
Tiranë	2,954,559	2,675,532	2,262,453
Vlorë	501,255	604,379	647,904

Burimi: Ministria e Financave, 2025

Për të pasur një interpretim edhe sipas ndarjes rajonale të bashkive, vihet re që Rajoni Qendror ka një trend rënës gjatë gjithë periudhës 2022-2024, ndërkohë që në kah të kundërt është trendi i shpenzimeve për Rajonin Jugor, dhe Rajoni Verior duket më i qëndrueshëm në shpenzimet për këtë funksion. Të dhënat jepen në Tabelën 12.

Tabela 12. Mbrojtja e Mjedisit, shpenzimet për rajon sipas klasifikimit funksional

Rajoni (mijë lekë)	2022	2023	2024
Rajoni Jugor	1,214,116	1,380,555	1,670,574
Rajoni Qendror	3,231,850	3,044,283	2,719,293
Rajoni Verior	1,589,423	1,598,206	1,558,822

Burimi: Ministria e Financave, 2025

Për të gjykuar mbi shpenzimet buxhetore për Ekonominë e gjelbër, edhe pse ka nuancë subjektivizmi, janë përzgjedhur gjashtë programet të cilët nga emërtimi i tyre tregojnë një lidhje të natyrshme me argumentin. Janë përzgjedhur gjashtë programe, si më poshtë:

- Menaxhimi i mbetjeve;
- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile;
- Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
- Ndërgjegjësimi mjedisor;
- Menaxhimi i ujërave të zeza dhe;
- Programet e mbrojtjes së mjedisit.

Vlera totale e shpenzimeve për këto programe në vitin 2022 arrinte në 8,762.6 milionë lekë, ose 10.99% e shpenzimeve totale të qeverisjes vendore sipas programeve. Tek ky grupim, peshën më të madhe e mban programi Menaxhimi i mbetjeve me rreth 5,879.5 milionë lekë, i cili është realizuar nga 41 bashki.

Tabela 13. Shpenzimet vendore sipas programit dhe numri i bashkive

Kodi	Programi	Nr. Bashkive	Shpenzimet në Lekë	Shpenzimet në % ndaj totalit
05100	Menaxhimi i mbetjeve	41	5,879,520,972	7.37%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	60	2,251,327,595	2.82%
04260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	60	510,885,590	0.64%
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	4	10,017,307	0.01%
05200	Menaxhimi i ujërave të zeza	11	110,889,046	0.14%
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	-	-	1
Totali 2022			8,762,640,509	10.99%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	54	5,838,965,404	7.28%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	57	2,729,228,914	3.40%
04260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	58	666,907,981	0.83%

05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	5	30,397,223	0.04%
05200	Menaxhimi i ujërave të zeza	2	28,960,372	0.04%
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	2	45,090,940	0.06%
Totali 2023			9,339,550,833	11.65%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	55	5,844,240,328	8.13%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	60	2,184,519,971	3.04%
04260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	60	677,268,577	0.94%
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	5	30,397,223	0.04%
05200	Menaxhimi i ujërave të zeza	2	28,960,372	0.04%
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	2	45,090,940	0.06%
Totali 2024			8,810,477,410	12.25%

Burimi: Ministria e Financave, 2025

Programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile kanë marr pjesë 60 bashki të cilat kanë shpenzuar vlerën e 2,251.3 milionë lekë, ose 2.28% të totalit të shpenzimeve vendore sipas programeve. Programi Ndërgjegjësimi Mjedisor, duket si një risi në listën e programeve, pasi ai implementohet nga vetëm 4 bashki dhe ka një vlerë modeste prej vetëm 10 milionë lekë. Duke analizuar të dhënat e Tabelës 13, vihet re se fondi total i shpenzuar për programet e seleksionuara është rritur në 9,339.6 milionë lekë në vitin 2023 dhe zinte rreth 11.65% të shpenzimeve totale vendore sipas programeve. Ndërkohë që për vitin 2024 pesha e shpenzimeve të programeve të seleksionuara arrin në 12.25% të totalit të shpenzimeve vendore sipas programeve, vlera në lekë është reduktuar krahasuar me vitin 2023.

Kjo nënkupton që fondi vendor për programet në tërësi është ulur gjatë vitit 2024. Për më shumë analizë të konsultohet Tabela 13.

Në raportin e Buxhetit Faktik për Qytetarët (MF, 2024) ⁴⁴ shprehet se shpenzimet faktike për argumentin “Mbrojtja e Mjedisit” ⁴⁵ kanë arritur në 8 Miliardë Lekë për vitin 2024, rreth 10% me shumë se viti 2023 dhe shpenzimet faktike kanë kaluar me 11.3% shpenzimet e planifikuara për këtë vit. Ato përbëjnë rreth 0.3% të PBB për vitin 2024. Po për këtë vit, janë realizuar 8534 raporte monitorimi për mjedisin dhe janë kryer 641 inspektime për parandalimin dhe shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore. Sipas raportit të Buxhetit për Qytetarët 2025 ⁴⁶, buxhetimi i Mbrojtjes

së Mjedisit mbetet në nivelin e 7 Miliradë Lekë, si dhe për vitin 2024. Edhe pse duket i vështirë krahasimi, për arsye të paqartësisë në metodologji për buxhetimin e gjelbër, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut ⁴⁷, fondet e shpenzuara për Mbrojtjen e Mjedisit” në vitin 2023 kanë arritur në rreth 144.17 Milionë Euro ⁴⁸. Rreth 35% e kësaj vlere është shpenzuar për Menxhimn e ujrave të zeza, rreth 21% për Furnizimin e ujit të qarkullueshëm, rreth 11% për Mbrojtjen e ajrit dhe klimës, dhe rreth 28.3% për Menaxhimin e mbetjeve. Kjo vlerë buxhetore e Republikës së Maqedonisë së Veriut duket shumë më e lartë se vlera që deklaron Ministria e Fiancave për të njëjtat shpenzime në Republikën e Shqipërisë.

3.4

FINANCIMET NGA DONATORËT DHE PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

Financimet nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë përbëjnë një shtyllë të pazëvendësueshme për zbatimin e Axsendës së Gjelbër në Shqipëri, duke mbuluar boshllëqet strukture, fiskale dhe institucionale që pengojnë tranzicionin drejt një modeli zhvillimi të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, Bashkimi Evropian, përmes Instrumentit të Para-Aderimit (IPA III), ka alokuar për Shqipërinë 67.35 milionë euro për vitin 2024, për të mbështetur projektet që lidhen me

energjinë e pastër, përmirësimin e efciencës energjetike në ndërtesat publike dhe nxitjen e energjisë fotovoltaike në sektorin familjar (European Commission, 2023a; European Commission, 2023b).

Dokumenti i politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” (AKR 2024-2027) konsiderohet si një instrument i rëndësishëm që do të nxisë përgatitjet ekonomike të orientuara nga tregu për përsheptimin e integritit të ekonomisë shqiptare në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, drejt progresit në konvergencë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vjen si kërkesë e kreut III të Rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian.

Dokumenti i politikës AKR 2024-2027 ofron një përmbledhje masash të përzgjedhura nga dialogu institucional Shqipëri – Bashkim Evropian, dhe hapash për krijimin e mjedisit të favorshëm për konsolidimin e transformimin ekonomik të vendit, i cili është i domosdoshëm për të rritur ritmin e rritjes dhe konvergencës socio-ekonomike me vendet anëtare në rrugën e anëtarësimit në BE.

AKR 2024-2027 përfshin masa që lidhen me prioritetet në fushat/shtyllat e politikave, ndër të tjera dhe Energjia/Tranzicioni i Gjelbër, si më poshtë vijon:

Klima e Biznesit

Kapitali Njerëzor

Energjia / Tranzicioni i Gjelbër

Tranzicioni Dixhital

Shteti i së drejtës / Themeloret

Në Tabelën 3 paraqitet një informacion i përmbledhur me financimin e pritshëm nga zbatimi i masave për AKR ku janë të përfshira kredi dhe grant, edhe pse jo të ndara sipas zërave, ku ajo që n intereson më shumë është Tranzicioni i gjelbër.

Tabela 3. Financimi i pritshëm (në euro) nga agenda e reformave 2024-2027

	2024	2025	2026	2027	Total
Impakti total (i pritshëm) në PBA nga AKR (Kredi + grant)	76,715,139	279,784,625	314,381,648	251,204,475	922,085,888

Burimi: Relacioni P/buxhetit 2025

Një kontribut i rëndësishëm vjen edhe nga *Green Climate Fund*, i cili ka financuar 5 projekte të ndryshme në Shqipëri me një vlerë kompesive 57.7 milionë euro ⁴⁹. Po ashtu, *Global Environment Facility* ka kontribuar me rreth 3 milionë euro në ndërtimin e kapaciteteve për integrimin e klimës në planifikimin publik përmes projektit rajonal *Capacity Building Initiative for Transparency*⁵⁰.

Banka Gjermane për Zhvillim (KFW) ka financuar një sërë projektsh në sektorin e energjisë dhe menaxhimit të ujërave në Shqipëri, përfshirë përmirësimin e impianteve të trajtimit të ujërave dhe reduktimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes së energjisë ⁵¹. Po ashtu ka pasur një sërë projektsh të ndryshme për Ndërmarrjet Shqipëtare përsa i përket zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve

klimatike si: Programi ProSEED 2.0, i financuar nga qeveria gjermane dhe i zbatuar nga GIZ, ka ofruar grante për rreth 75 ndërmarrje, përmes skemës “*Smart & Green Future*”, për të përmirësuar proceset e tyre duke përfshirë përbërës mjedisorë dhe dixhitalë ⁵². Programi “*Business Partnerships & Solutions for SDGs*”, i financuar nga SIDA dhe zbatuar nga UNDP, FAO, ILO, UNIDO, ndihmon në transformimin e ndërmarrjeve shqiptare drejt praktikave të qëndrueshme, me fokus te bizneset e draejtuara nga gra dhe të rinj ⁵³ (UNDP, 2024). Programi i EBRD për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM-ve), i bashkëfinancuar nga BE, ofron një kombinim të kredive dhe granteve për investime që rrisin sigurinë në punë, mbrojtjen mjedisore dhe efikasitetin energjetik sipas direktivave të BE-së ⁵⁴.

4. Tranzicioni i Gjelbër në Shqipëri: Politikat për Dekarbonizim, Ekonomi Qarkulluese dhe Mbrojtjen e Mjedisit

Shqipëria është angazhuar në një proces të thelluar transformimi drejt një modeli zhvillimi të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën. Në përputhje me objektivat e Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe synimet afatgjata të Bashkimit Evropian, vendi ka ndërmarrë një sërë reformash institucionale dhe ligjore në fushat e dekarbonizimit, eficiencës energjetike, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjes së biodiversitetit. Nën-çështjet në vijim do të japin një pasqyrë të politikave dhe masave kryesore të zbatuara në kuadër të tranzicionit të gjelbër në Shqipëri, duke analizuar përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare dhe sfidat në zbatim.

4.1

KLIMA DHE DEKARBONIZIMI

Dekarbonizimi përbën një nga komponentët më kritikë të Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe është në qendër të angazhimeve strategjike të Shqipërisë për të përmbushur objektivin e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050²³, në përputhje me

Deklaratën e Samitit të Sofjes (2020) dhe Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane. Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në këtë drejtim, veçanërisht në sektorin e energjisë, ku përqindja e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme arrin rreth 96%, kryesisht falë potencialit të madh hidroenergjetik të vendit (INSTAT, 2024). Ky progres është konfirmuar edhe në raportin “*Fostering Effective Energy Transition 2025*” të Forumit Ekonomik Botëror, ku Shqipëria renditet e para në botë për qëndrueshmërinë energjetike. Kjo arritje reflekton strukturën me emetime të ulëta të përzierjes së saj energjetike dhe rolin gjithnjë e më të rëndësishëm si një qendër rajonale energjetike dhe eksportuese neto (World Economic Forum, 2025). Megjithatë, raporti thekson se ky sukses nuk duhet të krijojë vetëkënaqësi: vendi duhet të intensifikojë diversifikimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, duke zgjeruar kapacitetet në energjinë diellore dhe atë me erë, si dhe të adresojë sfida të vazhdueshme si humbjet në rrjet dhe përmirësimi i infrastrukturës së rafinimit dhe transmetimit. Në këtë kuadër, shtylla e parë e Axhendës së Gjelbër:

POLITIKAT PËR KLIMË DHE DEKARBONIZIM

Klima, Energjia dhe Mobiliteti mbetet një fushë strategjike që kërkon një ndërhyrje të koordinuar ndërsektoriale, forcim të kapaciteteve institucionale dhe mbështetje të qëndrueshme financiare. Sfida të tilla si tranzicioni drejt transportit të pastër, integrimi i burimeve të shpërndara të energjisë, dhe përmirësimi i efikasitetit energjetik në sektorët publik dhe privat kërkojnë një vizion afatgjatë dhe bashkëpunim të ngushtë midis qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë (*Energy Community Secretariat, 2023*). Problem në Shqipëri ngelet ndotja, ku mungesa e ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve përbën një nga burimet kryesor të emetimeve së bashku me ndërtimin në zona të caktuara, i ndjekur nga sektori i transportit, që ka një rritje të ndjeshme të konsumit të karburanteve fosile dhe të ndotjes urbane (*Energy Community Secretariat, 2023*). Ndërkohë, mungesa e rrjeteve funksionale për transport publik të qëndrueshëm, bashkë me vonesat në zgjerimin e infrastrukturës për automjete elektrike, mbeten sfida të konsiderueshme. Zbatimi i kësaj shtylle të parë është një proces sfidues dhe ndërsektorial që kërkon përfshirje të qeverisjes lokale, investime publike dhe private, si dhe mbështetje teknike nga donatorët ndërkombëtarë. Monitorimi i progresit dhe matja e ndikimit të politikave mbeten kritike për të siguruar që Shqipëria të ecë drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe klimatikisht neutrale. Në këtë drejtim, indeksi i monitorimit i propozuar nga INDEP (2023) ofron një kornizë të vlefshme për të vlerësuar realisht progresin e vendit në zbatimin e shtyllës së parë të Axhendës së Gjellbër.

Shqipëria ka shënuar një progres të moderuar në zhvillimin e politikave për klimën dhe dekarbonizimin, duke u përpjekur të përputhet me objektivat e Axhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe të Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së. Përveç aspektit ligjor të cituar më sipër, Shqipëria është angazhuar të rrisë peshën e energjisë së rinovueshme në totalin e konsumit energjetik dhe të zhvillojë më tej komponentin diellor dhe atë të erës, për të diversifikuar përzierjen aktuale të mbështetur pothuaj tërësisht në hidroenergjia (ERE, 2025) ku energjia diellore e prodhuar ka kaluar nga 80.87 MWh që ishte në 2023 në 225.8 MWh në 2024 me një rritje komplekse prej 64.2% (duke arritur në rreth 4% të totalit të prodhimit). Megjithatë Shqipëria vazhdon të ketë një varësi të theksuar ndaj burimeve hidrike për prodhimin e energjisë (mbi 95%), vendi është tepër i ndjeshëm ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike, të cilat po ndikojnë ciklet hidrologjike reshjet janë më të pakta, shpërndarja e tyre më e paqëndrueshme, duke rrezikuar kështu sigurinë energjetike kombëtare. Përveç kësaj, humbjet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë janë në nivele të larta (18–20%), ndërsa konsumi final i energjisë ka arritur në 8.17 TWh në vitin 2024, i shtyrë nga rritja e urbanizimit dhe sektorit të shërbimeve.




Figura 1. Emetimi i CO2 për frymë në disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe “Upper Middle Income”

Burimi: Banka Botërore, 2025

Shqipëria ka ndërmarrë një qasje ambicioze për dekarbonizimin duke nisur nga vendosja e taksës mbi karbonin⁵⁶ te dekarbonizimi i sektorit të ndërtesave përmes një kornize ligjore dhe strategjike që synon ndërtesa me emetime zero deri në vitin 2050 duke përmirësuar edhe ndërtesat publike dhe ato private ekzistuese⁵⁷. Ligji për Performancën Energjetike të Ndërtesave (2025) përcakton standarde të reja për ndërtesat ekzistuese dhe të reja, përfshirë certifikimin energjetik, detyrimin për auditime dhe futjen e librezave të rinovimit. Strategjia Afatgjatë e Rinovimit të Stokut të Ndërtesave mbështet këtë ligj përmes skenarëve teknikë e financiarë për rinovimin e thelluar, duke adresuar ndërtesat rezidenciale, publike dhe tregtare, me

objektiva konkrete për çdo dekadë deri në vitin 2050. Masat përfshijnë izolim termik, ndërrim të sistemeve teknike, vendosje të paneleve fotovoltaike dhe përdorim të materialeve me emetime të ulëta në ciklin e jetës. Strategjia vendos gjithashtu norma të detyrueshme rinovimi për ndërtesat publike (3% në vit). Dekarbonizimi i sektorit mbështetet dhe nga miratimi i Ligjit nr.52/2024 “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”. Megjithatë riciklimi i mbetjeve ngelet akoma problem.

Tabela 14. Politikat për klimën dhe dekarbonizimin

Politikat për klimën dhe dekarbonizim	Statusi	Shkalla e zbatimit
Përafrimi me Ligjin e BE-së për Klimën dhe miratimi i një vizioni afatgjatë për neutralitetin klimatik deri më 2050	Ka progres	3
Vendosja e objektivave të detajuara për vitin 2030 në përputhje me Kornizën e Komunitetit të Energjisë dhe acquis komunitare të BE-së, dhe përgatitja e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën	Ka progres	3
Përgatitja e strategjive të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe forcimi i qëndrueshmërisë ndaj rreziqeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore	Progres i limituar	2
Harmonizimi me Skemën e Tregtimit të Emetimeve të BE-së dhe zhvillimi i instrumenteve të çmimit të karbonit	Nuk ka progres	4
Zhvillimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të zbutur dhe përballuar ndryshimet klimatike	Progres i limituar	2
Integrimi i klimës në politikat ekonomike dhe zhvillimore në nivel kombëtar dhe lokal	Progres i limituar	2
Zhvillimi i një mekanizmi për pjesëmarrjen e publikut dhe sektorit privat në Axhendën klimatike	Nuk ka progres	1

4.3

EKONOMIA QARKULLUESE

Me mbi 60% të tregtisë së saj të jashtme të orientuar drejt Bashkimit Evropian, Shqipëria mbetet fort e lidhur me ekonominë evropiane, duke e bërë BE-në partnerin e saj kryesor tregtar. Kjo lidhje e ngushtë ekonomike nënkupton jo vetëm përfitime tregtare, por edhe

sfida strategjike në lidhje me përafrimin e standardeve të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit afatgjatë. Një pjesë e konsiderueshme e ekonomisë shqiptare mbështetet ende në sektorë intensivë në burime, si energjia, ndërtimi, industria nxjerrëse dhe përpunuese, duke krijuar varësi strukturore nga burimet natyrore dhe prodhimi me ndikim të lartë mjedisor (INSTAT, 2025).

Kjo strukturë prodhuese e rrezikon vendin përballë presioneve për dekarbonizim dhe transformim drejt një modeli ekonomik më të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, nevoja për një tranzicion drejt një ekonomie qarkulluese është bërë urgjente. Një ekonomi qarkulluese nënkupton jo vetëm riciklim dhe reduktim të mbetjeve, por transformim të gjithë zinxhirit të prodhimit dhe konsumit për të rritur efikasitetin e burimeve dhe për të minimizuar humbjet mjedisore. Shqipëria ka bërë disa hapa në këtë drejtim. Në Gusht të vitit 2022, u miratua ndryshimi i Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, duke ndaluar përdorimin e qeseve plastike njëpërdorimëshe, në përputhje me Direktivën e BE-së për mbetjet dhe ekonominë qarkulluese ky ligj u rishikua përsëri në korrik të 2024 duke ndryshuar nenin 62 për Kundërvajtjet dhe sanksionet⁵⁸. Po ashtu, janë ndërmarrë iniciativa për të inkurajuar riciklimin dhe për të krijuar skema të mbështetjes për ndërmarrjet që aplikojnë praktika të qëndrueshme të prodhimit dhe paketimit, me mbështetje nga GIZ dhe projekte të financuara nga BE (GIZ⁵⁹, 2025; EU Delegation to Albania, 2025). Megjithatë, pavarësisht reformave ligjore, zbatimi praktik mbetet një sfidë e madhe.

Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve mbulojnë vetëm rreth 89% të popullsisë, kryesisht në zonat urbane, ndërsa zonat rurale mbeten shumë të nënfurnizuara.⁶⁰ Për më tepër, riciklimi i mbetjeve urbane është ende mjaft i ulët, më pak se 20% riciklohet, teksa pjesa dërmuese e mbetjeve vazhdon të depozitohet në landfille, përfshirë edhe ato jo-sanitarë që nuk plotësojnë standardet teknike të Bashkimit Evropian (OECD, 2024). Ky model linear koleksionim dhe depozitim ka qenë kritikuar në raportet e vëzhgimit mjedisor për dështimin në ndërtimin e infrastrukturës për grumbullimin e ndarë dhe për mungesën e mekanizmave efektiv të zbatimit të ligjeve⁶¹. Për të përshpejtuar tranzicionin drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore, Shqipëria ka nevojë për një kornizë të fortë rregullatore, instrumente ekonomike të efektshme dhe mekanizma të fuqishëm monitorimi. Mbështetja ndërkombëtare, përfshirë programet e OECD, GIZ dhe Bashkimit Evropian, ka ndihmuar në hartimin e dokumenteve strategjike dhe udhëzuesve praktikë, por sfida kryesore qëndron në ndërlidhjen e këtyre politikave me reforma strukturore në nivel vendor dhe në sektorin privat.

Tabela 15. Prodhimi i qëndrueshëm

Prodhimi i Qëndrueshëm	Statusi	Shkalla e zbatimit
Integrimi i Ballkanit Perëndimor në zinxhirët e furnizimit industrial të BE-së duke: Ndërmarrë veprime vendimtare për përmirësimin e qëndrueshmërisë së prodhimit primar të lëndëve të para;	Progres i limituar	2
Zbatuar një qasje të ekosistemit industrial për të çuar në një transformim industrial më të thelluar ekonomik në të gjithë rajonin, veçanërisht në drejtim të balancuar ekonomik dhe dixhital, duke përfshirë: dixhitalizim, teknologji të pastër, automatizim dhe furnizim të qëndrueshëm; rritjen e aftësive; transformim të industrive me intensitet të ulët; zinxhirë, transport, funksionalitet dhe industri të reja më rezistente;	Progres i limituar	2
Vënien në zbatim të një ekonomie qarkulluese duke prekur gjithë ciklin e jetës së produkteve; promovimin e eko-dizenjimit, nxitjen dhe rritjen e riciklimit, ripërdorimit dhe riparimit të produkteve;	Nuk ka progres	1
Ngritjen e sistemeve të qëndrueshme të qeverisjes për rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes për mbetje, grumbullimin e dhënave dhe riciklimin;	Progres i limituar	2
Të bëjë përparim në nismat/punën dhe ndërmarrjen dhe mbajtjen e partneriteteve si mekanizëm në mbështetje për rritje në rajone;	Nuk ka progres	1
Përfundimi dhe zbatimi i një nevoje për parandalimin e mbetjeve plastike, duke përfshirë etiketimin e qartë dhe zëvendësimin e materialeve;	Ka progres	3

NDOTJA E AJRIT UJIT DHE TOKËS

Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës përbën një nga sfidat më të mëdha mjedisore për Shqipërinë sot. Cilësia e ajrit, veçanërisht në zonat urbane si Tirana dhe Durrësi, ndikohet rëndë nga trafiku i dendur me mjete të vjetra, djegia e lëndëve fosile për ngrohje dhe aktivitetet industriale pa kontroll të mjaftueshëm mjedisor. Sipas raportit të fundit të ETC-HE (2025), në shumicën e stacioneve matëse në vend janë regjistruar përqendrime të larta të grimcave $PM_{2.5}$ dhe PM_{10} , shpesh përtej niveleve të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, me ndotjen më të madhe gjatë dimrit, kur përdorimi i qymyrit dhe drurit për ngrohje është më intensiv.⁶² Por ndoshta edhe më shqetësuese është gjendja e ujërave. Shqipëria renditet ndër vendet me nivelin më të lartë të ndotjes së ujit në Evropë. Lumenj si Lana, Ishmi apo Shkumbini kthehen nga burime të pastra në rrjedha të rrezikshme për shkak të derdhjeve të ujërave të zeza pa trajtim, mbetjeve urbane dhe mbetjeve industriale. Sipas të dhënave të SDG data për Shqipërinë, në vitin 2022 vetëm 56% e popullsisë ka akses në shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt (indikatori SDG 6.2.1a)⁶³ Po ashtu, vetëm 19% e ujërave të zeza (*wastewater*) trajtohen në mënyrë të sigurt në vend (indikatori SDG 6.3.1 për vitin 2022).

Kjo do të thotë se rreth 81% e ujërave të ndotura që prodhohen nga shtëpitë dhe komunitetet në Shqipëri nuk trajtohen apo pastrohen në mënyrë adequate përpara se të kthehen në natyrë.

Toka nuk i ka shpëtuar kësaj panorame. Ndërtimet paleje, depozitimi informal i mbetjeve dhe ndotja nga industria në shumë raste kanë degraduar zona të tëra, duke ndikuar jo vetëm në cilësinë e tokës bujqësore, por edhe në jetesën e komuniteteve rurale. Raporti i Institutit për Politikë Mjedisore (IEP) tregon se ndotja kimike nga mbetjet industriale në tokë po përhapet edhe në sistemet ujore dhe zinxhirin ushqimor, duke rritur rreziqet për shëndetin e njeriut.⁶⁴

Në këtë kontekst, Shqipëria ka nevojë për një kthesë serioze: investime të qëndrueshme, reforma në menaxhimin mjedisor dhe një qasje më njerëzore ndaj mjedisit që na rrethon. Sepse pas çdo grafiku ndotjeje, ka njerëz që marrin frymë vështirë, pinë ujë të pasigurt dhe punojnë në toka të lodhura nga kimikatet. Tranzicioni i gjelbër nuk është më një luks - është nevojë jetike për brezat që vijnë.

Tabela 16. Ndotja e ajrit dhe menaxhimi i ujit dhe tokës

Ndotja e ajrit dhe menaxhimi i ujit dhe tokës	Statusi	Shkalla e zbatimit
Zhvillimi dhe zbatimi i Strategjive të Cilësisë së Ajrit dhe rritja e përdorimit të teknikave më të mira të disponueshme në përputhje me Direktivat e BE-së	Progres i limituar	2
Krijimi i sistemit adekuat të monitorimit të cilësisë së ajrit, duke përfshirë akreditimin e rrjeteve të monitorimit të cilësisë së ajrit	Progres i limituar	2
Zbatimi i legjislacionit përkatës të BE-së në lidhje me ujin (Direktiva Kuadër e BE-së për Ujërat, Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane dhe Direktiva për Nitratet)	Progres i limituar	2
Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e ujërave të zeza	Ka progres	3

5. Gjetjet

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përafrimit me objektivat e Axhendës së Gjelbër, përmes hartimit të strategjive dhe miratimit të ligjeve të avancuara në fushat e klimës, energjisë së rinovueshme dhe mbrojtjes së mjedisit. **Megjithatë, kjo kornizë nuk pasqyrohet ende në mënyrë të qëndrueshme në politikat buxhetore.** Mungesa e një metodologjie të standardizuar për etiketimin e shpenzimeve të gjelbra (*“green tagging”*) dhe e një sistemi të qartë monitorimi e vlerësimi pengon matjen efektive të progresit dhe orientimin e politikave fiskale drejt objektivave klimatike.

Edhe pse legjislacioni për energjinë e rinovueshme, eficiencën energjetike dhe ndotjen ekziston dhe është pjesërisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së, shpesh **zbatimi i tij has në pengesa praktike.** Mungesa e akteve nënligjore, kapacitetet e kufizuara teknike dhe **koordinimi i dobët ndërinstitutional krijojnë një hendek të thellë mes qëllimeve ligjore dhe realitetit në terren.** Bashkitë dhe institucionet vendore, në veçanti, e kanë të vështirë të operojnë pa udhëzime të qarta dhe mbështetje financiare të mjaftueshme..

Alokimet buxhetore për mbrojtjen e mjedisit janë shumë të kufizuara dhe varen ndjeshëm nga donatorët ndërkombëtarë. Kjo varësi dobëson qëndrueshmërinë afatgjatë të financimit për mjedisin dhe redukton autonominë e politikave publike.

-Përkundër legjislacionit ekzistues, **ndotja e ajrit dhe e ujërave, veçanërisht në zonat urbane, vazhdon të përbëjë një sfidë madhore.** Kjo vjen si pasojë e mungesës së sistemeve të monitorimit në kohë reale dhe infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve dhe ujërave të ndotura. Treguesit për riciklimin dhe ekonominë qarkulluese mbeten në nivele shumë të ulëta krahasuar me mesataren evropiane, duke sinjalizuar mungesë të theksuar investimesh dhe kapacitetesh në këtë drejtim.

Zbatimi efektiv i buxhetimit të gjelbër kërkon jo vetëm instrumente ligjore dhe financiare, por edhe burime njerëzore të trajnuara dhe struktura të mirëorganizuara. Aktualisht, bashkitë dhe institucionet vendore shpesh nuk kanë kapacitetet administrative, njohuritë teknike apo mjetet e duhura për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar politika të bazuara në objektivat klimatike. Për rrjedhojë, shumë nga potencialet për veprim klimatik në nivel lokal mbeten të pashfrytëzuara.

6. Rekomandimet

-Integrimi i buxhetimit të gjelbër në kornizën ekzistuese të menaxhimit të **financave publike**, me të njëjtën logjikë si buxheti gjinor. Kjo arrihet përmes plotësimeve të ligjitorganik të buxhetit dhe akteve nënligjore, si dhe përditësimin e metodikave të buxhetimitvjetor dhe afatmesëm. Ky kuadër duhet të përfshijë dispozita të qarta për etiketimin dhekategorizimin e shpenzimeve me ndikim klimatik dhe mjedisor, në përputhje me praktikatmë të mira të BE-së dhe OECD-s. Në të njëjtën kohë sugjerohet **krijimi dhe vendosja enjë njësie të dedikuar pranë MTM për koordinimin**; ndërkohë, në çdo ministri të linjësugjerohet emërimi i një eksperti i politikave mjedisore, për të vlerësuar ndikimin mjedisortë çdo akti ligjor dhe për të lehtësuar vlerësimin e ndikimit të çdo programi buxhetor të ministrisë përkatëse. Kjo formë garanton koherencë ndërinstytucionale, shmang mbivendosjet dhe forcon llogaridhënien.

-Për të garantuar zbatim efektiv të politikave klimatike dhe mjedisore, **nevojitet forcimi i burimeve njerëzore në nivel qendror dhe vendor**, përmes trajnimeve teknike, asistencës së dedikuar dhe ngritjes së njësive të specializuara për klimën. Bashkitë kanë nevojë për mbështetje konkrete për të përmbyshur rolin e tyre në këtë tranzicion.

-Krijimi i një **Fondi Kombëtar për Mjedisin dhe Klimën** përbën një mjet të rëndësishëm për financimin e ndërhyrjeve klimatike, duke përfshirë kritere të qarta alokimi, objektiva të matshëm dhe mekanizma transparentë për vlerësimin e impaktit dhe efikasitetit të projekteve.

-Për të përmbushur objektivat e Marrëveshjes së Parisit, Shqipëria duhet të zbatojë një sistem kombëtar të integruar **për Monitorimin, Raportimin dhe Verifikimin** e emetimeve të gazeve serrë, të mbështetur nga teknologji moderne dhe burime njerëzore të trajnuara.

-Në sektorin e transportit, **nevojitet hartimi dhe zbatimi i një strategjie të re për dekarbonizim, e cila të përfshijë elektrifikimin e flotave publike**, ndërtimin e infrastrukturës së karikimit dhe promovimin e lëvizshmërisë urbane të qëndrueshme, në përputhje me objektivat e tranzicionit klimatik.

-Ndërtimi dhe modernizimi i **sistemeve për trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbetjeve** është thelbësor për të përmbushur standardet e BE-së dhe për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Këto ndërhyrje kërkojnë investime të targetuara dhe mbështetje teknike të vazhdueshme.

-Një komponent tjetër thelbësor është **integrimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë në politikat klimatike, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mbrojtjen e biodiversitetit** si instrumente për rritjen e reziliencës ndaj ndryshimeve klimatike.

-Rrjeti energjetik kombëtar kërkon **modernizim të thelluar për të integruar prodhuesit e vegjël të energjisë** dhe për të përballuar rritjen e konsumit. Investimet në infrastrukturën e transmetimit dhe shpërndarjes janë të domosdoshme për suksesin e tranzicionit të gjelbër.

-**Politikat për zhvillimin rural dhe bujqësinë duhet të riorientohen drejt qëndrueshmërisë klimatike**, duke përfshirë këshillimin teknik për fermerët, promovimin e teknologjive adaptive dhe përfshirjen e sektorit agro-ushqimor në politikat kombëtare të klimës

6. Bibliografi

- 1 [E miratuar përmes Deklaratës së Sofjes më 10 Nëntor 2020, Për zbatimin e deklaratës së Sofjes për axhendën e gjelbër për ballkanin perëndimor 2021-2030, shih: <https://www.rcc.int/files/user/docs/48b68eaf203f749aa599e14cee687f37.pdf>](https://www.rcc.int/files/user/docs/48b68eaf203f749aa599e14cee687f37.pdf)
- 2 [*Klima/ Ndotja: Zero emetime neto të gazeve sere; “Një tranzicion i drejtë për të gjitha komunitetet dhe punëtorët”; “ajri dhe uji i pastër, qëndrueshmeria \(pershtatja ndaj\) ndryshimeve klimatike dhe komunitetit, ushqimi i shëndetshëm, mjedis i qëndrueshëm” për të gjithë. - Punësimi: “Milionat vende pune të mira dhe më rrogë të lartë”; “prosperitet dhe siguri financiare për të gjithë”. - Barazia: “Parandalimi, ndalimi i shtypjes historike të komuniteteve me ngjyrë, komuniteteve migrante, komuniteteve të deindustrializuara, komuniteteve rurale të shpopulluara, të varfërve, punëtorëve me të ardhura të ulëta, grave, të moshuarve, të pa strehuarve, njerëzve me aftësi të kufizuara dhe të rinj”.*](#)
- 3 <https://www.rcc.int/files/user/docs/reports/RCC-Strategy-and-Work-Programme-2023-25-rich.pdf#page=32>
- 4 [*Shih: Ligji Nr. 75/2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, Në Kuadër të Konventës Kuadër Të Kombeve të Bashkuara, për Ndryshimet Klimatike” si dhe <https://www.unssc.org/courses/paris-agreement-climate-change-development-agenda-0>*](#)
- 5 [*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022 - 2030 është aprovuar nga Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 88/2023, datë 22.02.2023 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 31; <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim>*](#)
- 6 VKM Nr.872, datë 29.12.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar për energjinë dhe klimën 2020-2030. Shih: [https:// www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/VENDIM-872-dat-29-12-2021-1.pdf](https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/VENDIM-872-dat-29-12-2021-1.pdf)
- 7 <https://turizmi.gov.al/akte-rregullatore/> Strategjia është miratuar nga Qeveria e Shqipërisë në vitin 2019 dhe është hartuar në mbështetje të legjislacionit të BE për mjedisin dhe klimën dhe synon fuqizimin e koordinimit mes sektorëve lidhur me masat e përshtatjes, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

- 8 Climate Action Network Europe. (Nëntor 2022). NECP report – Western Balkans #3. Brussel: CAN Europe. Marrë më 2025, nga <https://caneurope.org/content/uploads/2022/11/NECP-report-Western-Balkans-3.pdf>
- 9 Shih: Bankë Botërore. (October 2024). Albania Country Climate and Development Report: Western Balkans 6 Country Compendium. Washington, D.C.: World Bank. Disponueshëm në <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099103024082037555/pdf/P17920514f0e1e0af1b3b019312cb6f0512.pdf>
- 10 Shih: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike-AL.pdf>
- 11 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006
- 12 Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3 - 30.
- 13 Projektligj Nr. /2024 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, Shih: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/772>; Data e mbylljes 17/09/2024.
- 14 Chapter XXVII Environment 7. d Paris Agreement Paris, 12 December 2015, Albania Ratification, 21-09-2016. Shih: https://treaties.un.org/pages/viewdetails.aspx?chapter=27&clang=en&mtdsg_no=xxvii-7-=treaty ;https://unfccc.int/files/national_reports/non-annex_i_nat-com/application/pdf/albania_nc3_13_october_2016.pdf?utm
- 15 Ligji nr. 24/2023, Fletorja Zyrtare Nr.64, datë 14/04/2023
- 16 Ligji Nr. 37/2025, Për performancën energjetike të ndërtesave shih:<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202506240828173355ligj%20nr.%2037%2C%20dt.%2016.6.2025.pdf>. Performanca energjetike e ndërtesave ka qënë e rregulluar më pare nga ligji nr.116/2026 i cili synonte përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke përcaktuar kërkesat minimale për ndërtesat e reja dhe ekzistuese, si dhe certifikimin e detyrueshëm të performancës energjetike. Ai parashikonte përdorimin e burimeve të rinovueshme, aplikimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes, si dhe objektivin që ndërtesat e reja të jenë me konsum pothuajse zero energji pas vitit 2020. Për më tepër shih: ligj nr. 116/2016 për performancën e energjisë së ndërtesave <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5109&token=f734e3f54cf4535ab6794ce8e5e790eb977f0113>

- 17 *Ligji nr. 124/2015, përfaqësuar me Direktivën 2012/27/BE*
- 18 *Ligji nr. 124/2015, përfaqësuar me Direktivën 2012/27/BE*
- 19 *Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011, përfaqësuar me Direktivën 2004/35/KE*
- 20 *Ligji nr. 10 440, datë 7.7.2011, përfaqësuar me Direktivën 85/337/KEE*
- 21 *Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011, përfaqësuar me Direktivat 2008/1/KE dhe 2001/80/KE*
- 22 *Ligji nr. 155/2020, përfaqësuar me Direktivën 2003/87/KE dhe Rregulloren (BE) 525/2013*
- 23 *Ligji nr. 2/2023, në zbatim të Amendamentit Kigali*
- 24 *Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011, përfaqësuar me Direktivën 2008/98/KE*
- 25 *Ligji nr. 162/2014, përfaqësuar me Direktivën 2008/50/KE dhe 2004/107/KE*
- 26 *Ligji nr. 27/2016, përfaqësuar me Rregulloren (KE) 1907/2006 (REACH) dhe Rregulloren (KE) 1272/2008 (CLP)*
- 27 *<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/06/26/9936>*
- 26 *OECD (2020), Green Budget Tagging: Introductory Guidance and Principles, shih: <http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/fe7bfcc4en.pdf?expires=1622814636&id=id&accname=ocid84004878&checksum=D6AC96224CDBC737F93235AFAA8C1FB9>.*
- 27 *IPCC (2022), Summary for policy makers, http://www.ipcc.ch/site/assets/uploads/sites/2/2022/06/SPM_version_report_LR.pdf*
- 28 *[content/uploads/2024/02/Udhezimi_nr.7_date_28.2.2018_Per_procedurat_Standarde_te_per-gatitjes_se_PBA.pdf](#)*
- 29 *<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2012/07/18/465>*

- 30 <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/udhezimi-nr.-7-date-28.2.2025.pdf>
- 31 <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Ligj-nr.-9936-date-26.06.2008-Per-menaxhimin-e-sistemit-buxhetor-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf>
- 32 World Bank, Country Climate and Development Report: Western Balkans 6 – Albania Country Compendium, October 2024, f.10. Në dokumentin në fjalë shpjegohet bëhet fjalë për Expected Annual Damages, d.m.th. një vlerë e pritshme vjetore me peshë probabilitare mbi rreziqet e shumta klimatike të llogaritura me një model makro që agregon kanalet kryesore të ndikimit: përmbytjet, thatësirat për produktet bujqësore si dhe, rënia e produktivitetin të punës
- 33 Shih në faqen 1: <https://economy-finance.ec.europa.eu/system/files/2023-05/European%20Union%20Green%20Budgeting%20Reference%20Framework.pdf>
- 34 The OECD (2018) defines green budgeting as “using the tools of budgetary policymaking to help achieve environmental goals. This includes evaluating environmental impact of budgetary or fiscal policies and assessing their coherence towards the delivery of national and international commitments. Green budgeting can also contribute to informed, evidence-based debate and discussion on sustainable growth”.
- 35 <https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/green-budgeting.html?utm>
- 36 [https://reform-support.ec.europa.eu/what-we-do/revenue-administration-and-public-financial-management/supporting-implementation-green-budgeting-practiceseu_en#:~:text=Context,GBRF\)%20for%20the%20Member%20States.](https://reform-support.ec.europa.eu/what-we-do/revenue-administration-and-public-financial-management/supporting-implementation-green-budgeting-practiceseu_en#:~:text=Context,GBRF)%20for%20the%20Member%20States.)
- 37 IPCC (2022), Summary for policy makers, http://www.ipcc.ch/site/assets/uploads/sites/2/2022/06/SPM_version_report_LR.pdf
- 38 Green Budgeting in Albania (Gusht, 2022). Shih: https://www.agora-parl.org/sites/default/files/agora-documents/ALB_Buxhetimi-i-Gjelber-ne-Shqiperi_Final.pdf
- 39 Shih: <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/negociatat-e-anetaresimit/kapitujt-e-acquis/kapitulli-27-mjedisi/>

- 40 OECD (2024), *Green Budgeting in OECD Countries 2024*, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/9aea61f0-en>.
- 41 Milieukontakt, 2022, “Buxhetimi i Gjelbër në Shqipëri” fq.14
- 42 MTM nuk raporton për programin Menaxhimi i mbetjeve për periudhën 2022-2024
- 43 Kjo statistikë nuk i përket institucionit të Qarkut. Duke bashkuar bashkitë sipas qarkut përkatës, është arritur një shumatore e shpenzimeve të tyre, sipas qarkut përkatës. Grupim i tillë është përdorur edhe për statistikat e Rajonit.
- 44 <https://financa.gov.al/buxheti-faktik-per-qytetaret/>
- 45 Në këtë klasifikim duhet të jenë marr parasysh të gjitha funksionet dhe programet, pa mbivendosje, që financohen nga buxheti i shtetit.
- 46 <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Buxheti-per-Qytetaret-Ministria-e-Financave-2025.pdf>
- 47 https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie_en.aspx?rbtxt=125
- 48 Vlera në dinar e konvertuar me kursim vjetor euro/dinar = 0.01623
- 49 <https://www.greenclimate.fund/countries/albania>
- 50 https://unfccc.int/sites/default/files/resource/cp2024_08E.pdf?utm_
- 51 <https://www.kfw-entwicklungsbank.de/Suchergebnisse-2.jsp?query>
- 52 SmartandGreenFuture, shih: <https://meki.gov.al/grante-me-skemen-smartgreen-future/>, 01/02/2024
- 53 Business Partnerships & Solutions for SDGs”, shih: <https://albania.un.org/en/218320-business-partnerships-solutions-sustainable-development-goals>, Start: 2024-01-01 End: 2027-12-31

- 54 EBRD, Supporting SMEs for access to the European Union market through improved competitiveness through loans and grants, shih: https://web-sme-csp.com/albania/wp_content/uploads/sites/6/2022/11/Brochure-Albania-ALB-20221121-F.pdf
- 55 Shih: https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal_it
- 56 LIGJ Nr. 96/2023, Pika 6, e nenit 4, Taksa e karbonit caktohet në masën: a) 1,5 lekë për litër për benzinën; b) 3 lekë për litër për gazoilin; c) për qymyrin: i. 4,5 lekë për kilogram nga data 1 korrik 2026; ii. 6.5 lekë për kilogram për vitin 2027; iii. 9 lekë për kilogram për vitin 2028; iv. 12 lekë për kilogram për vitin 2029; v. 15.3 lekë për kilogram për vitin 2030 dhe në vazhdim; ç) 3 lekë për litër për solarin; d) 3 lekë për litër për mazutin; dh) 3 lekë për litër për vajgurin; e) 3 lekë për kilogram për koks naftë. Shqipëria bëhet vendi i tretë në Ballkan për implementimin e kësaj takse mbash Bosnie Herzegovinës dhe Malit të Zi.
- 57 Ligji nr. 37/2025 për performancën energjetike të ndërtesave, i cili synon transformimin rrënjësor të mënyrës se si ndërtohen dhe rinovohen ndërtesat në Shqipëri, me objektivin që deri në vitin 2050, të gjitha godinat, publike dhe private të kthehen në ndërtesa me konsum minimal energjie. Përmes këtij ligji do të hyjnë në fuqi librezat e rinovimit të ndërtesave që ndihmon pronarët për investime eficiente dhe me benefite në aspektin energjetik. Gjithashtu synohet vendosja e paneleve diellore në objektet e reja dhe tek ato që do t'i nënshtrohen rinovimit. Synimi është që të gjitha ndërtesat e reja do të jenë të pajisura me pikën e karikimit inteligjent që duhet ta zbatojnë firmat e ndërtimit.
- 58 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar. Nr. i aktit: 70, Fletore Zyrtare nr.130, Data e publikimit në Fletore Zyrtare: 29/07/2024, Fusha e veprimtarisë: Mjedis dhe ndryshimet klimatike.
- 59 GIZ (2024). Local reusable packaging systems: Avoiding waste and empowering women. Circular City Labs – Testing reusable packaging systems in cities. Shi: <https://www.giz.de/de/downloads/giz2023-en-albania-reusable-packaging-systems-and-women-participation.pdf>; BE (2025). Shih: https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/new-approach-our-environment-how-eu-integration-process-supports-local-efforts-clean-recycle-and_en
- 60 INSTAT (2023). Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12579/urban-solid-waste-2022.pdf>; OECD (2024). Shih: https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2024/03/a-road-map-towards-circular-economy-of-albania_Ofd9c3a4/8c970fdc-en.pdf

- 61 Hana Center (19 Maj 2022). Hierarkia e trajtimit të mbetjeve e kthyer përmbys, nga riciklim në “varrosje” të mbetjeve. Shih: <https://www.hanacentre.org/2022/05/19/hierarkia-e-trajtimit-te-mbetjeve-e-kthyer-permbys-nga-riciklim-ne-varrosje-te-mbetjeve/>
- 62 ETC-HE Report 2025/2. Status report of air quality in Europe for year 2023, using validated data. Shih: <https://www.eionet.europa.eu/etcs/etc-he/products/etc-he-products/etc-he-reports/etc-he-report-2025-2-status-report-of-air-quality-in-europe-for-year-2023-using-validated-data>
- 63 <https://www.sdg6data.org/en/country-or-area/Albania>
- 64 <https://iep-al.org/environmental-issues-in-albania/pollution/?lang=sq>



Institute
for Democracy
and Mediation